



ANËTAR I FEDERATËS NDËRKOMBËTARE  
TË HELSINKIT  
Status konsultativ me Kombet e Bashkuara  
dhe Këshillin e Evropës

# RAPORT VJETOR 2003

I KOMITETIT TË HELSINKIT TË REPUB-  
LIKËS TË MAQEDONISË PËR GJENDJEN  
ME LIRITË DHE TË DREJTAT E NJERIUT  
NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

KOMITETI I  
  
PËR TË DREJTAT E NJERIUT  
I REPUBLIKES SË  
MAQEDONSË

Shkup,  
15 Janar 2004



## PËRMBAJTJA

Përmgledhje.....	4
1. Ngjarjet publike dhe shkelja e parimeve demokratike.....	5
2. Lëndimet e të drejtave ekonomike dhe sociale të qytetarëve.....	10
3. Të drejtat e njeriut.....	15
3.1 Policia dhe të drejtat e njeriut.....	15
3.2 Gjyqësia dhe të drejtat e njeriut.....	20
4. Personat e shpërngulur brenda vendit dhe refugjatët.....	25
5. Liria e të shprehurit dhe mediat.....	28
6. Marrëdhëniet ndëretnike.....	31
7. E drejta e lirisë të besimit dhe përcaktimit religjioz.....	36
Përfundim.....	38



## I. PËRMBLEDHJE

Raporti i Komitetit të Helsinkit pretendon që të ketë një përfshirje të situatës gjithëpërfshirëse me liritë dhe të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë. Analizat dhe vlerësimet e dhëna në raport bazohen në njohuritë me të cilat disponon Komiteti në bazë të rasteve që janë pranuar në Komitet, respektivisht që janë regjistruar nga ana e rrjetit të monitorimit të Komitetit.

Detyrimet kryesore dhe qëllimet kryesore që ka përcaktuar struktura e re qeverisëse në periudhën parazgjedhore dhe në momentin e përzgjedhjes në fund të vitit 2002 ishin: përmirësimi i situatës të sigurisë në shtet, përmirësimi i situatës ekonomike dhe përmirësimi i standardit jetësor të popullsisë, demokratizimi global, respektimi i të drejtës të zhvillimit të shtetit juridik, zhvillimi i proceseve integruese në vend të atyre dezintegruese në Republikën e Maqedonisë, dhe nivel i tillë i respektimit të përgjithshëm dhe mbrojtjes të lirive dhe të drejtave të njeriut që do ta afrojë shtetin deri te rrjedhat ekonomike dhe do të mundësojë përfshirjen e saj të përshpejtuar në strukturat europiane.

Edhe krahas pritshmërive të mëdha të qytetarëve dhe premtimeve të mëdha parazgjedhore<sup>1</sup> të dhëna nga ana e partive që kanë marrë pushtetin, në vitin 2003 nuk ka ardhur deri te një zhvendosje e madhe në fushën e promovimit dhe mbrojtjes të të drejtave dhe lirive të njeriut. Në disa fusha të jetës kemi indicje edhe për një trend retrograd në lidhje me vitin paraprak 2002. Shkelja e të drejtave dhe lirive të njeriut e përfshin strukturën e përgjithshme shoqërore dhe janë me përmasa aq të mëdha sa supozohet që të shtrohet çështja e orientimit global demokratik të pushtetit aktual.

---

1 Një pjesë madhe e premtimeve (madje edhe ato të përmasave më të vogla) mbesin në nivel të marketingut të zbrazët parazgjedhor. I tillë është për shembull premtimi i kryeministrit i dhënë me datën 29 nëntor të vitit 2002 se detyra prioritare për pushtetin e ri është zbulimi i fatit të personave të humbur; apo ajo që është dhënë nga ana e ministrit për punë të brendshme në lidhje me rastin “Vreshtat e Reshtakut” (kur afatet e dhëna të sakta në kuadër të së cilave do të zbardh rastin për të cilin ekzistojnë indicje se është kryer ekzaktimi jashtë gjyqësorë i 7 shtetasve të Pakistanit nga ana e anëtarëve të ministrisë të njëjtë).

# ● 1. Ngjarjet publike ● dhe shkelja e parimeve ● demokratike

Situata politike në Republikën e Maqedonisë në vitin 2003 ende është e përcaktuar nga zbatimi i dispozitave të Marrëveshjes kornizë të Ohrit. Edhe qeveria e re në mënyrë deklarative vazhdon me trendin e “realizimit të Marrëveshjes kornizë të Ohrit” (13.08.2001), edhe pse nga aspekti juridik mund të flitet vetëm për zbatimin ligjor të amendamenteve kushtetuese të cilat kanë hyrë drejtëpërdrejtë në fuqi pas votimit të tyre (16.11.2001). Arsyetimi për miratimin e ligjeve dhe ndryshimeve ligjore me nevojën për realizimin e Marrëveshjes të Ohrit në vend se si zbatim të amendamenteve kushtetuese mund të konsiderohet si shembull drastic i derogimit të parimit të sundimit të së drejtës.<sup>2</sup>

Ende të gjithë vendimet, ndryshimet strukturore dhe veprimi global në shtet paraqiten si rezultat i marrëveshjeve të drejtëpërdrejta partiake, në reth të larta të mbyllura partiake, me anashkalim të dukshëm të legjislacionit dhe devalvim të sundimit të së drejtës. Kjo sidomos i referohet ndryshimeve kadrovike të cilat realizohen gjatë gjithë vitit 2003 në të gjithë nivelet e administratës shtetërore. Për shkak të zbatimit dominant të kriterit partiak në ndryshimet personale të cilat realizohen në të gjithë nivelet e pushtetit, shumë shpesh ndryshimet, nuk kuptohen nga ana e popullsisë as edhe si zbatim i dispozitave të marrëveshjes, por si intervenim i drejtëpërdrejtë i partive politike në pushtet në të gjithë segmentet e shoqërisë. Kjo nga njëra anë sjell (në anën e bashkëshisës shumicë të maqedonasve) që ndryshimet të perceptohen si të tepërta, jo të duhura dhe jashtë ligjit, kurse nga ana tjetër (në radhët e shqiptarëve etnik) ata të perceptohen si të pamjaftueshme në aspekt të shfrytëzimit të të gjithë resurseve të disponueshme.

Nën mbulesën e “zbatimit të Marrëveshjes kornizë të Ohrit” në ndryshimet e përbërjes të administratës nuk respektohet Ligji për nëpunës shtetërorë (anashkalohet Agjencia për administratë shtetërore, nuk shpallen konkurset, nuk zbatohen kriteret dhe procedurat e përcaktuara; injorohet Ligji për marrëdhënie të punës; lëshohen vendime për ndërprerje të marrëdhënieve të punës pa udhëzim juridik, sistematizohen persona në vende ku tashmë është sistematizuar dikush tjetër apo në vende të cilat dihet se do të hiqen pas sistematizimeve

---

<sup>2</sup> Krahas të thirrurit të vazhdueshëm në Marrëveshjen kornizë të Ohrit, shumë indikative për zbatimin e amendamenteve kushtetuese është konstituimi i Komitetit për marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve në datën 18.09.2003, një vit e dhjetë muaj pas shpalljes të Amendamentit XII të Kushtetutës, Edhe pse Komiteti është kompetent që të shqyrtojë çështjet nga marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve, dhe të jap mendime dhe propozime për zgjidhjen e tyre (Kuvendi është i detyruar që të marrë vendim në lidhje me ato), i njëjti nuk është deklaruar në lidhje me disa raste të prishjes të marrëdhënieve ndëretnike në vjeshtën e vitit 2003 (Rasti “Brest”, rasti “hapje/zhvendosje të paraleleve”, etj.).

të reja, nuk respektohet e drejta e pushimit vjetor gjatë ndërprerjes të marrëdhënies të punës, nuk paguhen kompenzime për shpenzimet për jetën e ndarë, anashkalim i mekanizmit të procedurës disiplinore etj.). Qasja e tillë (e cila e mbështet dominimin e faktorit politik përballë modusit juridik dhe respektimin e ligjeve), pasqyrohet negativisht mbi zhvillimin e mëtutjeshëm të demokracisë i shpesh paraqet kërcënim për realizimin e, dhe jo rrallë edhe shkelje të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Nga njëra, në fakt qasja binacionale në marrëveshjen e Ohrit (që është tërësisht e pranueshme në kuadër të marrëveshjes me të cilën duhet të ndërpritet konflikti i armatosur), gjithnjë e më shumë ndeshet me karakterin multikulturor, multietnik dhe multikonfesional të shtetit<sup>3</sup>. Nga ana tjetër, dominimi i dimenzionimit etnik të secilit problem dhe të secilës marrëdhënie në shtet, e pengon zhvillimin e institucioneve demokratike, mekanizmave dhe marrëdhënieve, kurse demokracinë parlamentare e shëndreron në etnodemokraci. Praktika e marrëveshjeve partiake (që ishte karakteristike për partitë që kanë përbërë pushtetin në periudhën para paraqitjes të konfliktit të armatosur), në instancë të fundit sjell deri te jotransparenca e plotë<sup>4</sup> e proceseve të vendimmarrjes, i përjashton qytetarët nga këto procese

---

3 Në këtë kontekst i rëndësishëm të jashtëzakonshme është analizimi dhe shpallja e të dhënave nga regjistrimi i popullsisë të bërë në vitin 2002. Sipas këtyre të dhënave, Republika e Maqedonisë është me shumëllojshmëri etnike të popullsisë prej 2,022,547 banorësh prej të cilëve: maqedonas etnik janë 64.18%, shqiptar etnik janë 25.17%, turk etnik janë 3.75%, rom etnik janë 2.66%, serb etnik janë 1.7%, dhe disa komunitete tjera të vogla.

Që nga vetë fillimi, këto të dhëna janë parë si jashtëzakonisht të rëndësishme në lidhje me ndryshimet më të reja ligjore: për ndarjen territoriale, për përdorimin e gjuhëve zyrtare, për arsimin dhe strukturën e administratave publike etj. Gjithashtu, nga vetë fillimi i përpunimit të të dhënave, janë hedhur dyshime në materialin e grumbulluar, në futjen e të dhënave dhe në vetë përpunimin, që është potencuar me marginalizimin e komisionit të regjistrimit nga aktivitetet e ndërmarra.

Rezultatet e shpallura në fillim të dhjetorit të vitit 2003, kanë treguar një rritje domethënëse të pranisë të anëtarëve të bashkësisë etnike shqiptare në përbërjen e përgjithshme të popullsisë, kurse zvogëlimin e të gjithë bashkësive tjera. Kjo ka rezultuar në mohimin e hapur të rezultateve të regjistrimit nga ana e të gjithë bashkësive tjera etnike. Për shembull, edhe pse sipas të dhënave të shpallura në vitin 2003, në Republikën e Maqedonisë jetojnë 53,873 rom, vlerësimet e përfaqësuesve rom kanë arritur edhe deri në 136.000.

Numrat e fituar janë vendosur menjëherë në kontekst të realizimit të Marrëveshjes kornizë të Ohrit, pa i parë nën prizmen e terminologjisë kushtetuese. Në fakt, numri i përgjithshëm i qytetarëve të Republikës të Maqedonisë, nuk është paraqitur në publik edhe pse është e dhënë thelbësore për realizimin e amendamenteve kushtetuese. Për shembull, në lidhje me gjuhët zyrtare, në Kushtetutë qëndron në mënyrë shprehimore, se krahas gjuhës maqedonase, gjuhë zyrtare është “gjuha tjetër të cilën e flasin të paktën 20% e qytetarëve” (Amendamenti V) – që do të thotë, e dhënë relevante është numri i qytetarëve (shtetas të Republikës të Maqedonisë) e jo numri i banorëve që është fituar nga regjistrimi i realizuar.

4 Në 24 qershor të vitit 2003, Kuvendi i Republikës të Maqedonisë ka sjellur Vendimin për qasjen drejtë ndryshimit të Kushtetutës të Republikës të Maqedonisë. Vendimi përbëhet nga vetëm dy nene: 1) Qasja drejtë ndryshimit të Kushtetutës të Republikës të Maqedonisë, 2) Ky vendim hyn në fuqi menjëherë kurse do të shpallet në “Gazetën Zyrtare të Republikës të Maqedonisë”.

Me vendimin e tillë të pastër formal për qasje drejtë ndryshimit të Kushtetutës të Republikës të Maqedonisë, në të cilën nuk theksohen se cilët pjesë të Kushtetutës janë propozuar për ndryshim, Kuvendi i Republikës të Maqedonisë në fakt nuk e respekton parimin e transparencës në punë. Me mosshpalljen e elementeve kryesore nga propozimi për qasje drejtë ndryshimit të Kushtetutës – udhëzimet për ndryshim dhe plotësim të Kushtetutës dhe arsyetimi i arsyeve për shkak të të cilave propozohet ndryshimi dhe plotësimi i Kushtetutës (në pajtim me nenin 200 nga Rregullorja e Kuvendit) – Vendimi mbetet i paarsyeshëm kurse shpallja e tij në Gazetën zyrtare e pakuptimtë. Në të njëjtën kohë, Vendimi i tillë blanko praktikisht mundëson ngritjen

(mes të tjerash edhe me qasje të kufizuar ndaj informacioneve jetike<sup>5</sup>)<sup>6</sup> dhe i shëndreron në objekte të menaxhimit të cilët në përpjekje të realizimit të ndikimit personal mund të manifestojnë vetëm padëgjueshmëri dhe të bëjnë obstrukcion ndaj vendimeve shtetërore<sup>7</sup>.

Një nga indikatorët e situatës të tillë është mungesa e institutit të shqyrtimit publik për ndryshimet e ligjeve të cilat janë të rëndësishme jetike për qytetarët, formalizimi i transparencës në shpalljen e ndryshimeve<sup>8</sup> dhe mosshfrytëzimi i institutit të demokracisë të drejtëpërdrejtë<sup>9</sup>.

Sërish nën ombrellën e Marrëveshjes kornizë të Ohrit, përmasa enorme merr partizimi i të gjithë shoqërisë e sidomos të strukturave shtetërore. Kjo drejtëpërdrejtë pasqyrohet në korpusin e të drejtave të njeriut në aktet e dekriminalizimit të hapur në bazë të përkatësisë partiake.<sup>10</sup> Shqetëson sidomos përzgjedhja e zbatimit të së drejtës kur bëhet fjalë për ndjekjen

---

e procedurës për ndryshim të secilit nen nga Kushtetuta apo madje të të gjithë Kushtetutës pa arsytim të shkaqeve.

5 Pushteti është tepër i zellshëm në shpalljen e një numri shumë të madh të vendimeve të pavlefshme, si për shembull ai që është shpallur në Gazetën zyrtare të Republikës të Maqedonisë nr. 51/03; me të cilin publiku njoftohet se Qeveria e Republikës të Maqedonisë në seancën e mbajtur me 21 korrik të vitit 2013 ka marrë Vendim për dhënien e pajtueshmërisë për Vendimin për furnizim të fshesave me korent për pastrim të aeroplanëve.

6 Gjykata kushtetuese të mos inicojë procedurë për vlerësim të kushtetutshmërisë të neneve të caktuara nga Ligji për Amnesti, mes të tjerash duke u thirrur edhe në vendim tjetër (K. nr. 65/2002) në të cilin është vendosur që të mos inicohet procedure për vlerësim të kushtetutshmërisë të nenit 8 nga Ligji për amnesti me arsytim se “autorizimi i ministrit për drejtësi që të miratojë udhëzim për zbatim të ligjit nuk del nga kornizat kushtetuese, si dhe kornizat e parapara me Ligjin për organizim dhe punë të organeve të administratës, dhe që është në kuadër të vendosjes të administratës shtetërore”. Nga Ministria e drejtësisë kemi marrë informacion se udhëzimi i tillë për zbatim të Ligjit për amnesti ekziston, por nuk është shpallur në gazetën zyrtare. Që të merret ai Udhëzim duhet të dorëzohet kërkesë me shkrim në bazë të së cilës vendoset nëse do të bëhet dërgimi apo jo.

7 Demonstratat e të punësuarve në më shumë ndërmarrje në falimentim; të punësuarve nga gazeta ditore “Nova Makedonija”; demonstratat e të punësuarve të mëparshëm në Ministrinë për punë të brendshme; demonstratat e nxënësve dhe prindërve në Manastir (në lidhje me zhvendosjen e paraleleve në gjuhën e ligjëruar shqipe në shkollën amë Arseni Jovkov); demonstratat në lidhje me Ligjin e ri për ndarjen territoriale.

8 Në date 14.04.2003, Qeveria e ka sjellur Vendimin për miratimin e programit vjetor për interesin nacional në kulturë në vitin 2003 (Gz. Zyrtare e RM 29/03). Neni 1 thotë se “Me këtë vendim është sjellur Programi vjetor për interesin nacional në kulturë për vitin 2003” që sipas nenit 2, “hyn në fuqi ditën e ardhshme nga dita e shpalljes në “Gazetën zyrtare të Republikës të Maqedonisë”, kurse do të zbatohet nga data 01.01.2003”. Në këtë mënyrë, vendimi merr rëndësi retroaktive (ka efekt pothuajse 4 muaj më pas).

9 Referendumet e mbajtura me sjelljen e ligjit të ri për ndarjen territoriale.

10 Prizmi partiak është ndikuar nga shkarkimi i shpejtë i prokurorit publik republikan (pa arsytim të duhur dhe në procedurë shumë të shpejtë); ndërrimi i drejtorit të Agjencisë për nëpunës shtetërorë; ndërrimi i të gjithë anëtarëve të Këshillit gjyqësorë republikan (me ndryshimet ligjrore, për votimin e të cilit nevojitet shumicë e thjeshtë, jo vetëm që do të bëjë ndërhyrje të drejtëpërdrejtë në mandatin e përcaktuar kushtetues prej 6 vitesh, por do të shkojë deri atje që në “funksion të zbatimit të amendamentit” është ndryshuar e gjithë përbërja e këshillit); përzgjedhja e gjykatësve të Gjykatës kushtetuese.

Ndjekja penale për korrupsion dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare organizohet vetëm për oponentët politik, në të cilat raste sipas rregullit ose dilet nga normat ligjore ose ata interpretohen në mënyrë jashtëzakonisht ekstensive (rasti me paraburgimin e deputetit të mëparshëm Amdi Bajram dhe paraburgimi i anëtares të theksuar të VMRO DPMNE z-nja Slobodanka Çuklev; gjykimi i ministrit të mëparshëm të mbrojtjes Ljuben Paunovski; ndërhyrjet në shtepitë e njësisë të shpërbërë pranë MPB – Luanët etj.). Me shumë gjasa në pyetje është kriteri partiak në sjelljen e vendimit që të mos prishen ndërtimet e egra të ndërtuara në parkun e mbrojtur Vodno (sepse arsytimi me kushtet e paraqitura dimërore është definitivisht i papranueshëm).

Kriteri partiak si kryesor manifestohet edhe në punën e Komisionit të përhershëm anketues për mbrojtjen

e shkelësve të ligjeve të cilët u takojnë strukturave shtetërore dhe partiake të pushtetit (kur në dispozitat ligjore shihet nën dimensionin e tyre këshilldhënës dhe njerëzor), respektivisht, kur bëhet fjalë për anëtarë të partive opozitare apo qytetarëve që nuk u përkasin partive politike (kur domionon dimensionin penal).<sup>11</sup>

Shmangiet nga përcaktimi i deklaruar për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut zgjerohen edhe në aktivitetin ndërkombëtar të pushtetit aktual. Goditje e madhe mbi promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë ishte ratifikimi i marrëveshjes bilaterale për përjashtim ndërmjet Maqedonisë – SHBA me të cilin praktikisht mundësohet jondëshkueshmëria për veprat më të rënda penale, që është në kolizion më të drejtëpërdrejtë me dispozitat e statutit të Romës, tashmë të ratifikuar nga ana e Kuvendit. Në mungesë të shqyrtimit të argumentuar publik dhe pa arsytim përkatës, me ratifikimin, Kuvendi në fakt ka legjitimuar jo vetëm tregtinë e “të drejtës për jo të drejtën” nga ana e Qeverisë por edhe pretendimin e kryeministrit se interesi politik është më i fuqishëm se parimet juridike. Kjo paraqet lëndim të manifestuar jo vetëm të parimit të sundimit të së drejtës por edhe të parimeve themelore të së drejtës ndërkombëtare.<sup>12</sup>

Në strukturimin e përgjithshëm demokratik shqetëson fakti për mungesën apo

---

e të drejtave dhe lirive të njeriut pranë Kuvendit të Republikës të Maqedonisë që ka pasoja katastrofale në lidhje me të vendosurin për marrjen e qëndrimit si në lidhje me parashtresat nga ana e qytetarëve, ashtu edhe në lidhje me çështjet tjera që i shqyrton komisioni. Për shembull, edhe pse gjatë punës të komisionit pas parashtresës në lidhje me rastin “banesat sociale” janë paraqitur një numër i parregullive nga ana e pothuajse të gjithë anëtarëve të komisionit, votimi është realizuar nën direktivën e dukshme të qendrave partiake dhe tërësisht në kundërshtim me qëndrimet e paraqitura, argumentet dhe diskutimin e tërësishëm të deriatëhershëm.

Kriteri partiak është arsytimi i vetëm për disa ndryshime të bëra kadrovike në strukturat udhëheqëse të enteve publike dhe ndërmarrjeve (ndryshim i tërësishëm i kuadrit udhëheqës dhe anëtarëve të bordeve drejtuese në të gjithë organizatat buxhetore në të cilat Qeveria emëron apo merr pjesë në përzgjedhje (me përpjekje që të ndikohet madje edhe në emërimin e drejtorit të anëtares të Universitetit në Shkup: Instituti për hulumtim sociologjik, politik dhe juridik), ashtu që në vendimet e miratuara për shkarkim mungon argumentimi elementar për arsyet për ndërprerje të parakohshme të mandatit (vendimi për shkarkim nga detyra Drejtor i drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim dhe vendimi për shkarkim nga detyra drejtor i NP për menaxhim me hapësirën banesore dhe afariste të Republikës të Maqedonisë – Shkup; shkarkimi i një numri të ushtruesve të detyrës drejtor të organizatës të regjistruar për kryerjen e veprimtarisë me rëndësi të veçantë shoqërore nga fusha e kulturës në bazë të nenit 100, paragrafi 1 nga Ligji për kulturë që i referohet vetëm emërimit të drejtorëve, e në të cilin nuk bëhet fjalë për shkarkim; shkarkimi i një numri të madh të drejtorëve të shkollave fillore para ndërprerjes të mandatit të tyre dhe pa arsytim përkatës; ndërprerje e paarsyeshme e marrëdhënies të punës si pasojë e shkarkimit nga funksioni udhëheqës (si në rastin e drejtores të bibliotekës Vëllezërit Milladinov nga Shkupi).

<sup>11</sup> Vendimi për shkarkimin e ndërtimit të egër të ndërtuar nga ana e deputetit të mëparshëm Amdi Bajram në lagjen Shuto Orizarë (të cilën e ka shfrytëzuar e gjithë popullsia e lagjes, që është popullsi dominante rome dhe me paga shumë të ulëta, për mbajtjen e festave dhe festimeve private apo të përbashkëta pa kompensim) është sjellur dhe ekzekutuar shumë shpejtë, për dallim nga vendimi për prishjen e ndërtimeve pa leje të ndërtuara në parkun e pyllit të mbrojtur Vodno, prishja e të cilit është lënë për ditë më të ngrohta dhe me mundësi që disa prej tyre të përfshihen në planin e përgjithshëm urbanistik.

<sup>12</sup> Gjithashtu, pa një diskutim dhe arsytim të argumentuar, Kuvendi solli vendimin për pyetjen e njësisë të Armatës për pjesëmarrje në përbërje të forcave të koalicionit në operacionin “Liri për Irakun”. Ky vendim praktikisht mund të interpretohet si vendim për luftë, sidomos kur do të merret parasysh se në raportet e fundit të ekspertëve nuk janë përcaktuar arsye të mjaftueshme për intervenimin ushtarak në Irak, kurse humbjet e të ashtuq “koalicionit antiterrorist” janë më të mëdha në të ashtuq faza “pas-ushtarake” sesa në ato “ushtarake”.



mosfunksionimin e disa prej mekanizmave kryesore demokratike për kontrollin e pushtetit dhe mbrojtjes të drejtëpërdrejtë të lirive dhe të drejtave të qytetarëve. Me Ligjin për Avokatin e Popullit (Gz. Zyrtare e RM 60/03), praktikisht është zbatuar Amendamenti XI i Kushtetutës që në mënyrë domethënëse rriten si kompetencat ashtu edhe përgjegjësitë e avokatit të popullit. Komiteti i Helsinkit ka përshëndetur Ligjin si një bazë solide për vendosjen cilësore të këtij funksioni të mbikqyrjes mbi, para së gjithash të pushtetit ekzekutiv.

Për fat të keq, avokati aktual i popullit (që gjithashtu është zgjedhur si kuadër partiak nga ana e LSDM në momentin e konstituimit të këtij institucioni), e ka humbur mundësinë që në vepër të tregoj autorizimet e tij të reja, që do të paraqiste edhe fushatën më të mirë publike për mekanizmat e reja të vendosura për kontrollimin e pushtetit. Publiku thjeshtë nuk pati mundësinë të shoh se si avokati i popullit: a) Pa njoftim paraprak dhe miratim – hyn në stacionin policor, burg, departamentin psikiatrik apo organ tjetër shtetëror të administratës; b) Si ndërmerr masa konkrete në lidhje me ndonjë procedure afatgjate gjyqësore dhe në lidhje me mospërgjegjësinë e shërbimeve gjyqësore; c) si pa shtyrje është pranuar nga kryetari i Qeverisë apo presidenti i shtetit; ç) si bën kqyrje në informacionet më të besueshme (organet janë të detyrueshme që t’i sigurojnë të gjithë dëshmitë, të dhënat dhe informacionet, pa dallim nga shkalla e besueshmërisë); d) si jep iniciativa për ndryshimet ligjore dhe plotësimet deri te propozuesit e autorizuar; dh) si parashton propozim deri te Gjykata kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë të lidhjeve dhe ligjshmëria e rregullave tjera dhe akteve të përgjithshme; e) si thekson entin konkret shtetërorë ku ekziston përfaqësim jo i barabartë dhe jo i drejtë i bashkësive etj.<sup>13</sup> Komiteti i Helsinkit shpreh shqetësim se edhe përzgjedhja e ardhshme e avokatit të popullit do të jetë nga rradhët e kuadrove partiake (me çrast edhe ky institut do të bëhet pjesë e tregtisë partiake dhe mosmarrëveshjeve dhe me veprimin e tij nuk do të rrezikojë strukturat e pushtetit). Problem po aq të madh paraqet edhe mosekzekutimi i funksioneve të tilla nga ana e strukturave të cilat ndodhen në kuadër të kompetencave të tij<sup>14</sup>.

13 Në vend të kësaj, në fushatën promovuese për autorizimet e reja ligjore, avokati i popullit, mes të tjerash, ka theksuar se ky institucion është “mbrojtës i të mirave të administratës shtetërore” dhe se “gjithmonë kur e njëjta do të sulmohet pa bazë, ajo do të jetë e mbrojtur”. Në vend të fushatës informative për zgjidhjet e reja ligjore, që sidomos është drejtuar ndaj të gjithë personave të prekur (të punësuar në organet drejtuese, në stacionet policore, në prokurori dhe gjykata, persona në organizata dhe ente në të cilat liria e lëvizjes është e kufizuar) ishim dëshmitar i diçkaje që më shpejtë ngjante me fushatë zgjedhore. Gjatë punës të tij në vitin 2003, avokati i popullit hapur ka qëndruar në mbrojtje të qëndrimeve dhe interesave të LSDM (respektivisht pushtetit) me një sygjërim të papërmbajtur juridikisht për shpalljen e konkursit për shpërndarjen e banesave sociale.

14 As në përbërjen e tij të re, Kuvendi i Republikës të Maqedonisë nuk ka vendosur çështjen për shkeljen e rëndë të të drejtave të njeriut nga ana e presidentit të Republikës të Maqedonisë gjatë krizës të vitit 2001 (përdorimi i ushtrisë në territorin e Republikës të Maqedonisë pa votimin e gjendjes të luftës nga ana e Kuvendit të Republikës të Maqedonisë dhe votimin e objekteve civile që rezultoi me një numër të madh të viktimave civile gjatë konfliktit të armatosur. Kjo çështje ishte e domosdoshme që të vendosjes si nga aspekti i lokalizimit të përgjegjësisë të funksionerëve të lartë në organet e pushtetit për shkelje flagrante të të drejtave dhe lirive themelore, ashtu edhe në funksion të parandalimit të veprimeve të tilla në të ardhmen.

Presidenti aktual i Republikës në vitin 2003 ka parë një “ndëryrje në sistem” dhe me vendimin e tij për faljen e ministres të mëparshme për punë të brendshme, z-nja Dosta Dimovska, pa ndonjë arsytim përkatës, që

Proceset e pasqyruara në Republikën e Maqedonisë nuk ndihmojnë në rritjen e promovimit dhe mbrojtjes të lirive dhe të drejtave të saj. Sundimi i të drejtës dhe ekzistimi i mjeteve të disponueshme dhe për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarëve mbesin në nivel të aspirimit të përkufizuar lehtësisht, që nuk gjen vërtetimin dhe mbështetjen e saj në veprimin praktik në asnjë segment të pushtetit.

Gjatë vitit 2003, Komitetit i Helsinkit ka kushtuar vëmendje të veçantë disa fushave të lidhura me promovimin dhe mbrojtjen e lirive të njeriut të cilat gjatë kësaj periudhe ishin të interesit prioritar, respektivisht, ishin fusha të shkeljeve më të mëdha të të drejtave të njeriut.

- **2. Lëndimet e të drejtave**
- **ekonomike dhe sociale**
- **të qytetarëve**

Kundrejt përcaktimit kushtetues të Republikës të Maqedonisë si “shtet sovran, i pavarur, demokratik dhe social (neni 1), që duhet “të sigurojë drejtësi sociale, mirëqënie ekonomike dhe përparim të jetës të përbashkët personale” (Preambulla e Kushtetutës) dhe

---

është një lëndim i tillë i parimeve demokratike që është drejtuar drejtëpërdrejtë kundër thelbit të demokracisë ku qytetari është bartës dhe burim i sovranitetit të pushtetit. Me pengimin e procedurës për të dëshmuar shkeljen e nenit 17 të Kushtetutës (dokument për përgjim të nënshkruar nga personi i falur) presidenti edhe vetë është bërë bashkëpunëtorë në shkeljen e atij neni.

Presidenti disaherë ka deroguar edhe vetë segmentet e pushtetit (sërish në dëm të qytetarëve) duke injoruar Ligjin për lidhjen, ratifikimin dhe përmbarimin e marrëveshjeve ndërkombëtare gjatë të vendosurit për “çështjen irakiane”. Në fakt, presidenti praktikisht pa konsultime me çfarëdo trupi kompetent në shtet “ka vendosur” që të jap mbështetje pa dilemë në fushatën e SHBA-së dhe Britanisë të Madhe kundër “boshtit të së keqes”, duke marrë vendimin e tij jashtëzakonisht në bazë të asaj se “Maqedonia është pjesë e koalicionit antiterrorist”. Përfshirja e Maqedonisë në çfarëdo mënyre në koalicion ushtarak kundër Irakut në bazë të “vendimit” të tillë të presidentit, pa vendim përkatës të Kuvendit – ishte pa dyshim tejkallim i autorizimeve kushtetuese. Madje edhe Këshilli për siguri nacionale e shqyrtonte këtë çështje pas hapjes të diskutimeve për procedurat e tij.

Kohabitimi i keq mes Presidentit, Qeverisë dhe Kuvendit kishte pasoja katastrofale për funksionimin e shtetit në fusha të caktuara (për shembull mospërmblidhja e vendeve të ambasadorëve dhe mos kompletimi i përberjes të Gjykatës kushtetuese dhe Këshillit gjyqësor republikan, megjithatë edhe në lidhje me çështje aq të ndjeshme si fati i personave të humbur, ku presidenti pa koordinim me Qeverinë jepte premtime boshe).

Në veprimin e tij, presidenti lejoi shkeljen e dipozitës kushtetuese për ndarjen e religjionit nga shteti. Sipas më shumë revistave publike, promovimi i gjeneralit Stamboliski ka ndodhur në objekt kishtar. Komiteti i Helsinkit disa herë me shkrim është drejtuar deri te kabineti i presidentit me qëllim që të marr informacione për ngjarjen, megjithatë, nuk kanë marrë asnjë përgjigje (që mund të interpretohet si pranim të pretendimeve të bëra në media).

në kundërshtim me detyrimet e pranuar në pajtim me Paktin për të drejtat ekonomike, sociale, dhe kulturore, në vitin 2003 vazhdon trendi zhvillues negativ që sjell deri te shkelja e drejtëpërdrejtë e ekzistencës elementare të numrit të madh të njerëzve.

Në vitin e kaluar jo vetëm që nuk është bërë asnjë hap pozitiv në drejtim të përmirësimit të pozitës ekonomike dhe sociale të qytetarëve, por janë vërejtur edhe kufizime të mëtutjeshme, sidomos në fushën e mbrojtjes sociale dhe shëndetësore të qytetarëve. Prodhimtaria ende tregon trende negative (me zhvendosje të vogla pozitive në perioda të shkurtra). Numri i personave të papunë ka arritur mbi 400.000 persona; nuk është lëshuar në punë asnjë kapacitet më i madh prodhues, kurse investimet në bujqësi janë minimale dhe të pamjaftueshme për çfarëdo zhvendosje në këtë fushë (0,57% nga buxheti i tërësishëm për vitin 2003). Investitorët e jashtëm ende e konsiderojnë territorin e Republikës të Maqedonisë si një zonë të rrezikuar dhe nuk ka investime më domethënëse në cilëndo fushë.

Sipas të gjithë hulumtimeve të bëra dhe raportet e UNDP dhe Bankës botërore, varfëria po bëhet problem më i madh në Republikën e Maqedonisë. Pagesat e popullsisë kanë rënë nën minimumin ekzistencial për një pjesë më të madhe të popullsisë (rroga mesatare në Republikën e Maqedonisë gjatë vitit 2003 nuk tejkalon 200 euro, kurse përfitimet sociale nga ana e shtetit nga dita në ditë po zvogëlohen. Vlera maksimale ndihmës sociale për një muaj për një familje katër anëtarëshe është 50 euro, që nuk kënaq as nevojat elementare për ushqim të një personi për një muaj. Në periudhën paraprake është zvogëluar lista e ilaçeve që mund të merren pa pagesë (respektivisht të cilat mbulohen nga sigurimi shëndetësorë), kurse është rritur participimi gjatë secilit intervenim shëndetësorë. Varfëria në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe tërthortë e rrezikon realizimin e disa lirive dhe të drejtave themelore. Në Republikën e Maqedonisë ajo pasqyrohet para së gjithash mbi realizimin e të drejtës për arsim, mbrojtje shëndetësore, mbrojtje të grupeve të ndjeshme (në moshë të vjetër, fëmijë, gra, persona me hendikep), realizimi i të drejtave për një mjedis jetësor të shëndosh, të drejtat e punës dhe mbrojtja gjatë punës, e drejta në një standard të duhur jetësor dhe në vijë të fundit, dinjiteti i personit.

Përsësitet situata nga viti 2002 e cila karakterizohet me rritje të tensioneve sociale dhe prishjen e një pjese të madhe të të drejtave sociale të qytetarëve. Edhe këtë vit numri më i madh i rasteve të ankesave të qytetarëve, të cilat vijnë deri te Komiteti i Helsinkit janë pikërisht nga kjo fushë. Nëse kihet parasyh se ndërrimi i pushtetit në masë të madhe i referohet pikërisht rrezikimit të të drejtave të qytetarëve në këtë fushë, atëherë pushteti aktual nuk i është përgjigjur një prej prioriteteve kryesore për të cilën është zgjedhur.

Me një prej vendimeve të saj të para<sup>15</sup> Qeveria e ka fluar politikën kufizuese sociale.

<sup>15</sup> Qeveria, në dhjetor të vitit 2002 merr Vendim të tillë (Gz. zyrtare 91/2002) me të cilën ashpërsohen kriteret kryesisht në dy baza: a) me atë që kërkuesit “me parashtrimin e kërkesës dorëzojnë llogari për energjinë elektrike të shpenzuar të cilat janë në emër të titullarit të së drejtës apo anëtarit të familjes të tij”; dhe b) “me parashtrimin e

Si rezultat i kësaj politike “me krenari” është publikuar e dhëna se do të pushojnë së pranuari ndihmë sociale mbi 200.000 qytetarë në Republikën e Maqedonisë. Komiteti I Helsinkit nuk mund të gjejë mirëkuptim për interpretimet e Qeverisë të parimit të drejtësisë sociale dhe të drejtës të ndihmës sociale në të holla për personat e aftë për punë, pa sigurim social. Është e sigurtë se ka persona që e kanë keqpërdorur apo që do të keqpërdorin sistemin e mbrojtjes. Por gjithashtu është e sigurtë se nuk mundet as edhe rastësisht të jetë 20 mijë qytetarë. Krahas asaj, sikur të gjithë harrojmë se bëhet fjalë për më shumë se 2.400 denarë pa dinjitet. Qeveria, duket se ka harruar se thelbi i solidaritet social është se çdo qytetar në shtetin tonë duhet të ketë të siguar një minimum social që do të përbëhet nga: minimumi financiar për ekzistencë (që nuk mund të jetë më i vogël se 6.200 denarë për peron), “kulm mbi kokë” dhe “pako” mjekësorë. Edhe njëherë të theksojmë – ky është minimumi. Zvogëlimi mekanik i numrit të shfrytëzuesve të ndihmës sociale me futjen e kriterëve të reja apo shtrëngimin e atyre ekzistuese, në kushtet e papunësisë të madhe, në asnjë rast nuk mund të perceptohet si hap pozitiv në realizimin e kursimeve buxhetore dhe mbulimin e deficitit buxhetor.<sup>16</sup>

Me disa masa të saj Qeveria intervenon në fushën sociale në mënyrë që prish vazhdimësinë juridike dhe paraqet shkelje të hapur të ligjeve dhe mënyrës jo të drejtë të organizimit të të drejtave të qytetarëve të realizuara në periudhën paraprake.<sup>17</sup>

---

kërkesës të dorëzohet edhe kontratë për qera për shfrytëzimin e hapësirës përkatëse banesore”. Menjëherë pas njoftimit të “kriterit të ri” – numëruesit elektrik, Komitetit i Helsinkut dorëzoi kërkesë deri te Ministria për punë dhe politikë sociale, sipas të cilës sekretari shtetëror i kësaj ministrie është përgjigjur se: a) Ministria ka dorëzuar njoftim deri te qendrat për punë sociale që kërkesat për ndihmë sociale detyrimisht të pranohen pavarësisht nëse me dokumentacion të kompletuar është dorëzuar edhe fatura për energjinë elektrike të shpenzuar; b)

Se mundësia për të poseduar një numërues, respektivisht arsyet se pse një amvisëri nuk ka numërues të tillë do të përcaktohen pas kqyrjes të drejtëpërdrejtë; c) se me këtë “jepet mundësi për të fituar dhe shfrytëzuar të drejtën e ndihmës sociale në të holla” dhe kërkuesve të cilët nuk do të parashtrajnë faturë të energjisë elektrike nëse bëjnë pjesë në një prej 13 kategorive të personave të theksuar.

Megjithatë, krahas kësaj, deri te Komiteti i Helsinkit janë drejtuar më shumë qytetarë me ankesa se megjithatë u është zvogëluar ndihma sociale në të holla, në numrin më të madh të rasteve sepse nuk kanë poseduar fatura për energji elektrike në emër të kërkuesit apo anëtarit të familjes së tij, kurse një pjesë edhe për shkak të saj se nuk kanë poseduar kontratë për qera të banesës. Nga këto ankesa rrjedh se kriteret korrektuese të theksuara në përgjigjen e Ministrisë, faktikisht nuk janë zbatuar.

16 Në seancën e mbajtur në 22 maj të vitit 2003, Gjykata Kushtetuese e Republikës të Maqedonisë e ka shfuqizuar nenin 1 dhe nenin 2 paragrafi 3 dhe 4 nga Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për kushtet, kriteret, lartësinë, mënyrën dhe procedurë për përcaktimin dhe realizimin e të drejtës të ndihmës sociale të marrë në datë 2.12.2002.

Në vendimin për shfuqizim (Gz zyrtare nr. 37/03), Gjykata kushtetuese se kështu siç është vendosur “... autorizimi i Qeverisë nuk është operacionalizuar në dispozitën ligjore nga neni 29 paragrafi 2 nga Ligji për mbështetje sociale, por bazë për përcaktimin e të drejtës në ndihmë sociale në të holla...”, kurse që nuk është në fushë të asaj që është realizuar por të pushtetit ligjvënës. Rrjedhimisht, kjo është në kundërshtim me vlerat themelore të rregullimit tonë kushtetues – ndarja e pushtetit shtetëror në atë ligjvënës, egzekutiv dhe gjyqësor.

Pas shfuqizimit të dispozitave të pabazuara juridike të Qeverisë, që ishin promovuar me ndryshimet e fundit jopopullore (faturat për energji elektrike dhe kontratat për qera të banesës), në të cilat Komiteti I Helsinkit disa herë ka treguar në raportet e tij, silltet në pikpyetje e gjithë Strategjia e Qeverisë të Republikës të Maqedonisë në fushën e mbrojtjes sociale.

17 Me arsyetim se shpërndarja e banesave të ndërtuara si ndihmë sociale familjeve me të ardhura të ulëta, e bërë

Madje edhe masat pozitive të ndërmarra me qëllim të zvogëlimit të shfrytëzuesve të ndihmës sociale me sigurimin e tyre në mënyrë produktive siç është dhënia në shfrytëzim e tokës të papërpunuar, nuk realizohen në mënyrë që mundet më të vërtetë të paraqesë hap në drejtim të zgjidhjes të problemit.<sup>18</sup>

Lëndimi i të drejtave nga marrëdhëniet e punës gjithashtu merr vendin e rëndësishëm në trendet negative të mbrojtjes të të drejtave të njeriut. Në vazhdimësi me vitin paraprak edhe viti 2003 karakterizohet me shkelje të mëdha të Ligjit për punësim<sup>19</sup>, të drejtat të cilat rrjedhin

---

nga përbërja e mëparshme e Qeverisë nuk është bazuar mbi kriteret përkatëse dhe se janë bërë shkelje faktike të së drejtës në përpilimin e listave të shfrytëzuesve, Qeveria e shkeli konkursin e përfunduar dhe ka filluar të gjithë procedurën nga fillimi. Pas shqufizimit të konkurseve për banesat sociale nga ana e Qeverisë, qytetarët që kanë fituar të drejtën e qerasë kanë dorëzuar padi për kontest administrative deri te Gjykata administrative e Republikës të Maqedonisë kundër Vendimit për shfuqizim, si dhe iniciativë për vlerësimin e ligjshmërisë të vendimit të njëjtë të Qeverisë deri te Gjykata kushtetuese në Republikën e Maqedonisë.

Gjykata kushtetuese në datë 13.02.2003 ka marrë Vendim me të cilin ka hedhur poshtë padinë me arsyetim se është e palejuar. Në fakt, sipas Gjykatës kushtetuese, me padi për kontest administrativ mund të kontestohet vetëm akti administrativ, kurse gjykata ka vërtetuar se “Vendimi i shënuar i Qeverisë të Republikës të Maqedonisë nuk ka karakter të aktit administrativ në aspekt të nenit 5 nga Ligji për konteste administrative.”

Gjykata Kushtetuese në datë 8.04.2003 ka marrë Vendim me të cilin e hedh poshtë iniciativën për ngritjen e procedurës për vlerësim të kushtetueshmërisë dhe ligjshmërisë të Vendimit të Qeverisë, me arsyetim se Vendimi për shfuqizim nuk është rregull, e përshtatshme për vlerësim kushtetues gjyqësorë. (Për gjykatën, që nisat nga përmbajtja e Vendimit të kontestuar, “e njëjta nuk mundet sipas karakterit të tij të paraqes rregull, në aspekt të nenit 110 alineja 2 nga Kushtetuta” sepse ka efekt juridik vetëm në lidhje me personat që kanë lidhur kontratë për qera në bazë të konkurseve tashmë të shfuqizuara”). Gjithashtu, në arsyetimin e tij, Gjykata kushtetuese konstaton se “Në këtë rast **Konkursi**, paraqet një thirrje të përgjithshme për një numër të pakufizuar të personave të interesuar që të lidhin kontratë dhe i njëjti sipas karakterit të tij **nuk është rregull** por veprim i ndërmarrë për realizimin e procedurës konkrete të rregulluar më parë për dhënien e banesave të përcaktuara saktë me qera.” Me këto vendime, qytetarët janë sjellur në situatë të vakumit juridik dhe pamundësisë që të mbrojnë të drejtat e tyre.

Me qëllim që të jepet vlerë juridike, Qeveria ka marrë Vendim të ri për kushtet dhe kriteret për shpërndarjen e banesave të ndërtuara me “Projektin për ndërtimin e banesave të cilat do u jepen me qera personave me të ardhura të ulëta” (Gz. Zyrtare e RM 51/03), me të cilën praktikisht ka pushuar që të vlejë Vendimi për mënyrën dhe procedurën për shpërndarjen e banesave të ndërtuara me “Projektin për të ndërtimin e banesave të cilat u jepen personave me të ardhura të ulëta” (Gz.zyrtare e RM 104/00, 97/01 dhe 8/02). Me vendimin e ri zbatohet parim i vlefshmërisë retroaktive negative për qytetarët që janë të përfshirë drejetëpërdrejtë në rast, janë paraparë kriteret e reja, megjithatë të përgjithshme të barabarta dhe jo të sakta si dhe në të mëparshmin, Qeveria në mënyrë të njëanshme e ka shkëputuar marrëdhënien detyrimore të vendosur për qytetarët dhe nuk ka gjetur mënyrë për shkarkimin e tillë të problemit që do të marrë parasysh specifikat e secilit rast individual, në mënyrë të veçantë.

Sipas informacioneve të fundit të marra përmes mediave, Qeveria ka filluar me ri-shpërndarjen e disa prej banesave sociale (në Gostivar tri banesa janë dhënë jashtë prej listave të bëra sipas kriterëve të reja, për nevojat e Qeverisë).

18 Në kontekst të mosekzistimit të politikës të përgatitur për zhvillim të bujqësisë, numri i vogël i kriterëve të përkufizuara gjërisht mund të sjell deri në pikpyetje shpërndarjen e drejtë të tokës; nuk kushtohet kujdes për regjistrimin e rregull të fermerëve individual të cilët do të duhet më vonë të gëzojnë të drejtat nga sigurimi shëndetësor dhe social; shfrytëzuesit e ardhshëm nuk lirohen nga taksat administrative; nuk garantohen subvencione në formë të ndihmës, dhënies të kredive të favorshme për furnizimin e mekanizimit dhe pajisjes dhe të ngajshme.

19 Largimi nga puna i Gabriela Trajçevskës nga Germanos Telekom për shkak të mungesës nga puna gjatë kohës të shtatzanisë; ndërprerja e marrëdhënies të punës të grupit të qytetarëve për shkak të mungesës nga puna gjatë kohës të konfliktit të vitit 2001, kundrejt përfundimeve dhe rekomandimeve të Qeverisë – rastet e punëtorëve nga ADG Mavrova, Shkrites MZT, Mak-stil Shkup – komuna e Haraçinës

nga marrëdhëniet e punës<sup>20</sup> dhe roli i pavetëdijshëm i vetë sindikateve të cilët e harrojnë rolin e tyre.<sup>21</sup> “Ndryshimet kadrovike, strukturore dhe teknologjike” janë justifikimet më të shpeshta mbi kuptimin abstrakt dhe të paarsyetuar të të cilave bazohen largimet jo ligjore dhe masive<sup>22</sup> të punëtorëve për shkak të pjesëmarrjes në grevë.<sup>23</sup> Zhvendosjet kadrovike në Ministrinë për Punë të Brendshme në mënyrë specifike pasqyrojnë gëzimin e të drejtave të punëtorëve.<sup>24</sup>

Inspektorati shtetëror i punës, si institucion kompetent që kryen mbikqyrje mbi zbatimin dhe respektimin e ligjeve në lidhje me marrëdhëniet e punës dhe të drejtat të cilat rrjedhin nga marrëdhëniet e punës, nuk është përgjigjur në detyrat e vendosura dhe kërkesat për përditësim më të madh si organ kompetent në aspekt të rasteve të dokumenteve të falsifikuara, në dhënien e ndihmës dhe udhëzimit juridik gjatë veprimit në kërkesat e punëtorëve për mbrojtjen e të drejtave të tyre<sup>25</sup>.

*Përfundim i përgjithshëm që mund të nxirret në lidhje me gjendjen me të drejtat e qytetarëve në fushën e të drejtave ekonomike është se kjo fushë e madhe e mosrespektimit më të madh të rregullativës nacionale dhe ndërkombëtare nga ana e të gjithë niveleve të pushtetit dhe se pushteti ndërton strategji të tillë për qytetarët që gjithsesi janë varfëruar me çka krijohen kushte të tensioneve të vazhdueshme sociale dhe situatë e konfliktit të mundshëm social.*

*Ndoshta ilustrimi më i mirë për shmangien e detyrimeve të pushtetit aktual është fakti*

---

20 Komiteti i Helsinkit ka apeluar deri te Qeveria për vendim për largim nga puna të lëshuara nga ana e saj, që të respektojë detyrimet dhe procedurat ligjore të shkarkimit, sidomos në pjesën e arsytimit dhe transparencës të vendimeve të tilla. (rastet e vendimeve të paarsyetuara dhe të parakohshme për shkarkim të Drejtorit të drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim, Drejtori i NP për menaxhim me hapësirat banesore dhe afariste, dëshmojnë praktikën e tillë të Qeverisë).

21 Në rastin “Kiro Juçuk” në luftën e përbashkët për ndikim, dy sindikatet e ndryshme kanë harruar në tërësi mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve.

Është indikativ vendimi i Qeverisë (Gz. Zyrtare e RM nr. 51/2003) që të jape një të katërtën e mjeteve të përgjithshme të destinuara për shoqatat e qytetarëve për Unionin e sindikatave (që nuk është organizatë joprotabile dhe nuk është regjistruar si shoqatë e qytetarëve sipas Ligjit për shoqatat e qytetarëve dhe fondacioneve).

22 Largimi nga puna i një numri më të madh të punëtorëve nga ESM pa një procedurë të përmbajtur juridike, kurse në disa prej rasteve për shkelje të rëndë të ligjeve nacionale dhe akteve të pranura ndërkombëtare (si në dy rastet e dy punëtorëve të larguar nga puna gjatë kohës të shfrytëzimit të pushimit të lindjes); ndërprerjes të marrëdhënies të punës të një numri më të madh të punës nga Fondi për sigurim shëndetësor;

23 Rasti me SHA Kiro Juçuk – Veles tërhiqet dhe këtë vit është përforcuar me 39 vendime të reja për ndërprerje të marrëdhënies të punës.

24 Gjatë shpërndarjeve të dyshimta të punëtorëve nga MPB në vende tjera (shpeshherë në vende jo të duhura) një pjesë të tyre u është pranuar e drejta e shpenzimeve për jetë të ndarë nga familja në lartësi prej 60% nga rroga mesatare e punëtorit e paguar në ekonominë e Republikës të Maqedonisë në tre muajt e ardhshëm, llogaritur nga dita e shpërndarjes. Edhe pse personat kanë vendime të nënshkruara nga ministri për punë të brendshme me të cilat u njihet e drejta e përmendur (se kanë përmbushur kushtet nga neni 27 dhe neni 87 paragrafi 1 alineja 4 nga kontrata kolektive e Ministrisë për punë të brendshme) shpenzimet për jetë të ndarë apo nuk janë paguar aspak apo pagesa është ndërprerë me arsyetim se nuk ka mjete buxhetore.

25 Shkelje të shpeshtë të të drejtave është mungesa e arsytimit dhe mungesa e udhëzimit juridik në vendimet për ndërprerje të marrëdhënies të punës.

se në Maqedoni ende nuk janë marrë hapa për ratifikim të Kartës të reviduar sociale europiane – akt që në planin ekonomik – social paraqet ajo që Konventa Europiane për të drejtat e njeriut paraqet në planin e të drejtave dhe lirive qytetare – politike të qytetarit.



## 3. Të drejtat e njeriut

### 3.1 Policia dhe të drejtat e njeriut

Gjatë vitit të kaluar është thelluar procesi i degradimit të rolit të policisë në dy linja paralele. Nga njëra anë, policia vazhdon që të shkel ligjin duke mbetur jashtë shtrirjes të së drejtës. Nga ana tjetër, një pjesë e popullsisë, sidomos anëtarët e bashkësisë shqiptare, kanë vazhduar që të ushqejnë një mosbesim të hapur ndaj policisë të uniformuar dhe të kundërshtohen çdo lloji të veprimit të policisë dhe të protestojnë çdo formë të veprimit të policisë dhe të protestojnë gjatë çdo arrestimi të kryer mbi anëtarët e këtij komuniteti duke u vendosur jashtë dhe mbi ligjin dhe duke krijuar situatë të kaosit juridik dhe institucional.

Detyrat specifike që duhej me prioritet të realizojë policia në vitin 2003 ishin: ndryshime në përbërjen etnike të policisë; reforma në drejtim të ngritjes të efikasitetit të saj si dhe në drejtim të mbrojtjes më të madhe të të drejtave dhe lirive të njeriut; ngritjen e nivelit të sigurisë të përgjithshme të popullsisë dhe sidomos të sigurisë në zonat të cilat ishin prekur nga konflikti në vitin 2001.

Rezultati i përkushtimeve të deklaruar njëvjeçare as së largu nuk është i kënaqshëm:

- 1. Edhe krahas ndryshimeve evidente në strukturën etnike të policisë (të cilat para së
- gjithash janë të orientuara kah përfaqësimi më i madh i anëtarëve të bashkësisë etnike
- shqiptare, dhe jo edhe kah ndryshimet e vërteta multikulturore në përbërje), nuk është
- rritur ndjeshmëria e policisë për dallimet kulturore, religjioze dhe etnike<sup>26</sup>. Është për

26 Josensibilizimi i policisë për aspektet specifike të tensioneve ndëretnike dhe konflikteve erdhi më shumë në shprehje në aksionin për bastisje në shtëpitë në lidhje me rastin “Sopot”. Vlerësimi i Komitetit të Helsinkit për mospërshtatjen e veprimit policor në Sopot ndaj nevojave të veçanta të personave të cilët kanë qënë drejtëpërdrejtë të prekur gjatë bastisjeve të dhunshme në shtëpitë (indicjet e qarta për mosrespektimin e dinjitetit të njeriut, privatësisë, integritetit personal, dhe mosveprimi në pajtim me interesin më të mirë të fëmijëve) përputhet me rezultatet nga kqyrja e drejtëpërdrejtë e ekipit të Avokatit të popullit. Rezultatet kanë treguar

- tu çuditur ajo se në asnjë prej trajnimeve të cilat realizohen me pjesën e uniformuar të policisë nuk është vendosur theks në këtë mangësi të policisë.
- 
- 2. Patrullat e përziera etnike policore të cilat duhet të kthejnë besimin e popullsisë në polici, nuk kanë realizuar kontroll efektiv mbi zonat në të cilat lëvizin dhe pjesëmarrja e tyre mbeti në nivel të pranisë formale në terren. Policia ka vazhduar që të shfrytëzojë “shërbimet” e ushtrisë në kryerjen e aksioneve në territorin e Republikës të Maqedonisë (rasti Brest) duke pretenduar se të dyshuarit për veprimet e caktuara kriminale nuk janë civil dhe duke shfrytëzuar retorikë ushtarake të panjohur për të drejtën penale.<sup>27</sup>
- 
- 3. Në vend se në funksion të mbajtjes të rendit publik dhe paqes, dhe zbatimit të ligjit, shpesh policia paraqitet në rol të gjeneratorit të tensioneve si në planin e marrëdhënieve ndëretnike ashtu edhe në planin e shfrytëzimit të dhunës mbi qytetarët e paarmatosur të cilët nuk paraqesin kërcënim në asnjë bazë. Mosbesimi i popullsisë po rritet për shkak se policia nuk arreston por ndëshkon dhe vret, nuk mbron por kërcënon dhe frikëson, nuk bashkëpunon por manifeston fuqi dhe fut frikë.
- 
- 4. Prezumimi i pafajsisë prishet shumë shpesh me deklaratatë të dhëna në media nga ana e personave zyrtar nga Ministria për punë të brendshme, respektivisht në paraqitjet zyrtare, dhe konferencat për shtyp të zëdhënësës të Ministrisë për punë të brendshme.<sup>28</sup>

“sjellje që është dukshëm jo e duhur, jonjerëzore dhe johumane ndaj personave të caktuar nga ana e anëtarëve të policisë që kanë kryer bastisjen, dhe tejkalimin e autorizimeve zyrtare, respektivisht veprim në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin”. Megjithatë, për udhëheqësit e MPB, rezultatet nga puna e “komisionit të përzier prej shtatë anëtarësh pranë MPB (me përfaqësues nga OSBE) ka treguar se veprimi policor është “përgatitur në rregull” dhe se janë bërë vetëm tejkalime të “vogla” të detyrës zyrtare. Për çfarë “tejkalime të vogla” (që ka vërtetuar komisioni) bëhet fjalë mund të shihet vetëm nga njoftimi i OSBE, që nuk është në dispozicion për publikun e gjërë. Për fat të keq, për paraqitja e anshme dhe e rrejshme e gjetjeve të komisionit, që nuk ishte në interes të kthimit të besimit të humbur ndaj policisë nga ana e publikut, askush nuk mban përgjegjësi.

27 Policia është lëshuar në aksion për “shkatërrimin” e grupeve kriminale/ekstremiste/terroriste pa treguar urdhër përkatës gjyqësor dhe pa i theksuar veprat penale për të cilat ekzistojnë bazat e dyshimit. Kjo ka sjellur deri te rënia dramatike e besimit të qytetarëve ndaj rendit publik dhe paqes, madje deri te zhvillimi i animozitetit për shkak të “arrestimeve në befasi” të vendasve që nuk kanë asnjë lidhje të dukshme me strukturat kriminale që veprojnë në atë rajon.

28 Në vend se të shfrytëzojë terminologjinë nga Ligji për punë të brendshme, nga LPP, dhe KP, MPB shfrytëzon fjalor që prejjudikon fajin e personave të caktuar (që i quan “kriminelë të dëshmuar”) pa e theksuar veprën penale për të cilën ekzistojnë bazat e dyshimit, pa theksuar se janë parashtruar kallzime penale dhe, eventualisht, nëse janë ngritur kallzime penale nga ana e prokurorit publik. Për shembull, në shkresën e publikuar në Dnevnik (30 tetor të vitit 2003) të nënshkruar nga MPB, krahas demantit të deklaratave të një shoqërie të qytetarëve, është theksuar verifikimi se personi G.S., të cilit i është ndërprerë marrëdhënia e punës, e ka dëmtuar MPB duke keqpërdorur 17 milion denarë. Në të njëjtën shkresë, personat aktual udhëheqës në MPB e kanë shprehur verifikimin se kontrabanda me naftë dhe duhan ka qënë shenjë mbrojtëse e paraardhësve të tyre të cilët “transportet e tilla të naftës dhe derivateve të naftës i kanë bërë me njohuri të Qeverisë dhe drejtorit të Drejtorisë të doganave dhe me miratimin e partnerëve të tyre të atëhershëm të koalicionit në pushtet” (Dnevnik 30 tetor, 2003). Pastaj, në shkresën e publikuar në Dnevnik (“Lotët e krokodilit të Gruevskit”), MPB ka akuzuar se “... manipulimet me të mëdha (rezervistët dhe anëtarët e NJISH “Luanët” janë bërë nga VMRO-DPMNE dhe nga ministri i atëhershëm për financa”. Gjatë kësaj, MPB na informon se edhe fletarresti i fundit për personin Dime Ickovski” për veprën penale vjedhja i lëshuar tre ditë para zgjedhjeve parlamentare, kur ende ishin aktuale strukturat udhëheqëse të VMRO DPMNE në gjyqësi dhe polici.” Në vend se në rol të grumbullimit të dëshmimeve për shkak të parashtrimit të kallzimit penal, MPB paraqitet edhe në rol të prokurorit dhe gjykatësit.



- 5. Qytetarët kanë dërguar ankesa të shumta për veprimin policor të cilat i referohen:
- bastisjeve të kundërligjshme, arrestimeve arbitrave (pa urdhër për arrestim, të shoqëruara me mbajtjen disaditore të të arrestuarve dhe me një trajtim tërësisht jo adekuat të të arrestuarve në stacionet policore), dhe veprimet tjera të cilat paraqesin tejkalim të autorizimeve të policisë. Diapazoni i lëndimeve sistematike është tepër i gjërë: arrestimi pa vendim gjyqi dhe pa i paraqitur arsyet e arrestimit; sjellja me forcë në polici me ekspozimin e kureshtjes publike; mos informimi me të drejtat e personave të arrestuar; moslëshimi i dokumentit me shkrim në të cilin është shënuar baza dhe arsyet e mbajtjes; paraqitja jo e duhur dhe jo zyrtare, keqtrajtimi dhe poshtërimi gjatë legjitimitit, mos përgatitja e raportit gjatë legjitimitit etj.<sup>29</sup>

E paraqitur nga ana e mediave me indicjet e shumta për shkeljen e të “drejtave të njeriut” në procedurën hetimore të udhëhequr kundër të dyshuarës Slobodanka Çukleva, MPB në konferencën për shtyp, para “gjqit të publikut”, ka paraqitur “fatura” të cilat do të duhet që të shërbejnë si kurora e dëshmisë në procedurën gjyqësore kundër të akuzuarës. Edhe në këtë si dhe në shumë raste të mëparshme është marrë qëndrimi se shkelja e të drejtave të njeriut mund të arsyetohet kur posedohen “dëshmi të sigurt” për fajin e të dyshuarit dhe se “dëshmitë e sigurt” e bëjnë të panevojshme ekzistimin e sistemit të përgjithshëm gjyqësor.

29 Tregojmë vetëm disa shembuj ilustrues:

Në Shën Nikollë, në vend të urdhërit gjyqësorë, policët kanë treguar një letër në të cilën janë shkruar dhjetë emra të të rinjve të cilët duhet të arrestohen.

Jovçe Lazoroski (shofer në Okta) është marrë në pyetje në stacionin policor në Kumanovë nga ana e policëve civil të cilët nuk janë legjitimuar, nuk kanë njoftuar për arsyet e arrestimit, as që kanë njoftuar për të drejtat e tij. Dy javë më vonë (në date 06.08.2020) Lazoroski është arrestuar sërish nga ana e personave zyrtar të autorizuar, sërish pa asnjë arsyetim.

Kameramani i TV “Tera” Toni Petrushevski ka qënë ndalur në mënyrë të dhunshme nga ana e grupit të special të MPB pas “dramës të pengjeve” në Manastir. Petrushevski, nga ana e policisë, është ofenduar rëndë, kasete me materialin e regjistruar i është marrë dhe është arrestuar në stacionin policor pa qënë i njohur me arsyet dhe me të drejtat e tij.

Petre Nikoloski, anëtar i mëparshëm i njësisë “Luanët” në datën 06.11.2003 reth orës 02.00 të mëngjesit është arrestuar me dhunë nga ana e nëpunësve policor pa vendim gjyqësorë dhe është dërguar në SP Prilep pa qënë i informuar për arsyet e arrestimit.

Arrestimet arbitrare kanë vazhduar edhe në vitin 2003 dhe qëllimi i tyre ishin para së gjithash anëtarët me bindje të ndryshme politike (partiake). Viktima të arrestimeve të kundërligjshme, por edhe të dhunës policore, ishin edhe anëtarët e caktuar të MPB (nga njësia e mëparshme kontraverse “Luanët”). Ende vazhdon praktika e mosevidentimit të të arrestuarve në stacionet policore, me çrast shmanget përgjegjësia për arrestimin pa urdhër. Ende shfrytëzohet instituti “arrestimi për shkak të realizimit të bisedës informative” (që është shfuqizuar tashmë një kohë të gjatë me vendim të Gjykatës kushtetuese). Në Shtip, ftesa për “bisedë informative” me treguesin të paraqitet “menjëherë” pasi që personi është paraqitur vullnetarisht në stacionin policor.

Në numrin më të madh të rasteve “bisedat informative” shfrytëzohen si presion mbi qytetarët që të japin dëshmi para policisë. Pas lëshimit në liri, qytetarëve u jepet dëshmi për bazueshmërinë dhe ligjshmërinë e mbajtjes, të arsyetohen në punë etj. Kur Komiteti i Helsinkit kërkon sqarim për arresimin e Ana Kunoskës (pa urdhër, pa qënë e informuar për arsyet, dhe pa qënë e nxjerrur para gjykatësit hetues) kemi marrë përgjigje nga SP Kisella Vodë, në të cilin është theksuar se A.K. ka qënë e “mbajtur” në stacionin policor në orën 21.15 në bazë të shënimit zyrtar për mbajtjen e personit me udhëzim për të drejtat të lëshuar nga ana e inspektorëve DTP pranë SPB - Shkup “. Inspektorët e njëjtë në fillim kanë shkelur të drejtën e paprekshmërisë të shtëpisë të saj, e më vonë kanë fituar urdhër për bastisje, pa lëshuar procesverbal për të njëjtin.

Komiteti i Helsinkit tregon në mangësi të shumta gjatë bastisjes: bastisje pa udhër gjyqi; bastisje në të cilat në fakt nuk dihet se çfarë kërkohet; bastisje në hapësira të cilat nuk janë theksuar në udhërin gjyqësor (për shembull, gjatë bastisjeve kontraverse në Shtip në urdhër është dhënë adresa Vera Cirivi Trena nr. 29 në Shtip

- 6. Metodat e torturës dhe sjelljes poshtëruese ende paraqesin përditshmëri në veprimin
- policor dhe nuk janë lëndë e kontrollit të veçantë, ndjekjes dhe sanksionimit përkatës.
- Personat e privuar nga liria dhe të arrestuarit në stacionin policor nuk kanë qasje
- të rregulltë në mjek, kurse për mjek sipas përzgjedhjes personale as që bëhet fjalë. E
- drejta në trajtim mjekësor nuk është rregulluar as me rregulla ligjore as me rregulla të
- brendshme dhe është lënë që të zgjidhet nga rasti në rast. Në raste të caktuara, kur ekipet
- e ndihmës të shpejtë janë detyruar që të intervenojnë në stacionin policor, personat që
- kanë marrë trajtim mjekësor nuk mund të merrnin vërtetimin mjekësor nga stacioni. Në
- numrin më të madh të rasteve, të dhënat në vërtetimet mjekësore nuk tregojnë se në cilën
- mënyrë janë shkaktuar lëndimet.<sup>30</sup> Këtë vit kemi vërejtur edhe dy raste të keqtrajtimit
- policor të të punësuarve në media.<sup>31</sup> As gjykatat dhe as prokuroria publike jo vetëm që

kurse bastisja është kryer në pajtim me atë që është theksuar në procesverbalin në v.q Suitlak, shtëpi fundjave; bastisje vetëm me tregimin e urdhërit (pa ja dorëzuar të njëtin qytetarit, si në rastin gjatë bastisjes të shtëpisë të komandantit të “Luanëve” Stojkov, në orët e mbrëmjes); bastisje pa dëshmitar (pa asnjë arsyetim); mosdhënia e e procesverbalit për bastisje; futja e të dhënave të pasakta në procesverbal; mosdhënia e vërtetimeve për sendet e marra (rasti “Sopot”) etj.

Mosinformimin e qytetarëve për të drejtat e tyre, policia e shfrytëzoi edhe duke u thirrur në rregulla jo ekzistuese. Në një njoftim të nënshkruar nga shefi i DPM – Kisella Vodë qëndron se është kryer arrestimi i personave në pajtim me Rregulloren për kryerjen e punëve të shërbimeve të sigurisë publike. Megjithatë, kjo Rregullore e vitit 1985 është shfuqizuar që nga shkurti i vitit 1998 me hyrjen në fuqi të Rregullores të re për kryerjen e punëve në Ministrinë e punëve të brendshme!

Edhe krahas asaj që Gjykata kushtetuese në periudhë prej disa viteve vazhdimisht sjell vendime me të cilat përpiqet që të ndërpres praktikën e arrestimit jo të ligjshëm të policisë maqedonase, MPB vazhdimisht injoron vendimet e Gjykatës kushtetuese. Gjykata kushtetuese në vitin 1999 ka shfuqizuar disa dispozita nga Rregullorja e MPB nga viti 1998 (neni 21 paragrafi 1 pika 3, neni 29 dhe neni 31). Megjithatë, në vend se të informojë anëtarët e policisë për ndryshimet e përmendura, MPB në vitin 2013 ka shtypur doracakun policor në të cilin është shpallur “Rregullorja për kryerjen e punëve të ministrisë për punë të brendshme” (ai nga shkurti i vitit 1998) së bashku me nenet e shfuqizuara.

Avokatëve nuk ju jepet mundësia që të kontaktojnë të vetëm me personat e dyshuar që të mundën të këshillojnë dhe atëherë kur marrin pjesë në marrjen në pyetje mund të vëzhgojnë pasivisht. Pas arrestimit të Jovçe Lazoroski nuk i është lejuar që të bisedojë me avokaten e tij e cila tashmë ndodhet në stacionin policor e që konfirmon se vazhdimisht kërkon të marrë pjesë në marrjen në pyetje të klientit të saj me çrast i është dhënë përgjigje se do të arrestohet nëse nuk del nga stacioni. Lazoroski është lëshuar ditën e ardhshme në ora 09:00, pasi që është detyruar që të nënshkruaj procesverbalin në të cilin thuhet se nuk ka kërkuar avokat .

Kushtet për mbajtje në stacionet policore janë të këqija dhe jo njerëzore, sidomos në periudhën dimërore sepse hapësirat për mbajtje sipas rregullit janë në podrum dhe pa ngrohje. Personave që mbahen më gjatë nuk ju sigurohet ushqim ashtu siç është paraparë me Rregulloren e Ministrisë. Nuk ekzistojnë standarde për trajtim të veçantë të grupeve të rrezikuara, si të miturit, personat me hendikep dhe të ngjajshme. Gjatë paraburgimit, takimet me familjen janë shumë të kufizuara, kurse në disa raste mungojnë në tërësi. Policia vazhdon me përdorimin e pakontrolluar të armës të zjarrit gjatë arrestimit të të dyshuarve. Gjatë vitit 2003 kjo ka sjellur deri te vdekja e më shumë të dyshuarve për vepra penale gjatë arrestimit të tyre. Në rastin Dimçe Ickoski, familja e të vrarit ka shprehur dyshim të hapur se është bërë ekzekutim jashtë gjyqësor (rethanat e rasti janë mjaftë të dyshimta, kurse deklaratat kontradiktore në lidhje me obduksionin e plotësojnë këtë përshtypje), megjithatë, komisioni i formuar për shqyrtimin e rasti (në të cilin ka marrë pjesë edhe përfaqësues nga OSBE) ka vërtetuar përdorim të arsyeshëm të forcës.

30 Shembull drastik paraqet vdekja e Blagoj Stojanovski, në datë 5.12.2003 në burgun hetues të Manastirit “Ura e Zezë” i cili ka vdekur për shkak të mosdhënies të ndihmës mjekësore në gjendje të dëmtimit të dukshëm të shëndetit.

31 Kameramani i TV “Tera” Toni Petru{evski dhe kameramani i televizionit TELMA, z. Mitko Zatkovski.

- nuk shfrytëzojnë autorizimet e tyre ligjore në funksion të pengimit të keqpërdorimeve
- policore po nuk kanë vullnet për të ndërmarrë çfarëdo veprimi në atë drejtim.<sup>32</sup>

32 Për dallim nga viti 2001, e pjesërisht edhe nga viti 2002, kur ishte karakteristik fukosimi territorial dhe personal i rasteve të torturës apo veprimit jonjerëzor apo poshtëruës, kjo nënkupton shpërndarjen e zonave të goditura nga kriza dhe përhapje me një tregues relativisht të qartë etnik, në vitin 2003 erdhi deri te shpërndarja territoriale, dmth rastet janë përhapur në të gjithë territorin, kurse treguesi etnik është përhapur edhe ndaj popullsisë shumicë. Në fakt, numri më i madh i viktimave në rastet ku është përfshirë Komiteti i Helsinkit në ndonjë mënyrë ishin maqedonas etnik (reth 20 raste) më tutje romë (4 raste të procesuara dhe 2 jo të procesuara), si dhe 4 shqiptar etnik. Rasti më serioz është shqiptari nga Kosova (që është mbajtur në paraburim pa iu dhënë plumbat e fituara në përleshje me policinë maqedonase) dhe maqedonasi etnik që ka vdekur në paraburgimin e Manastirit (rasti më i ri – elementet po vërtetohen).

Edhe një karakteristikë e rëndësishme është se është “mbuluar” praktikisht i gjithë diapazoni i rasteve tipike: nga rastet e torturës gjatë arrestimit dhe marrjes në pyetje në stacionin policor (për shembull, rasti me të akuzuarin për terrorizëm Avni Ajeti, që është mbajtur katër ditë në “përpunim policor” para se të vetë inkriminohet para gjykatësit hetues; rasti i Jocko dhe Dalibor Vlačoski që janë rrahur brutalisht në garazhat e policisë; rasti i “luanit” të mëparshëm Petre Nikoloski), deri te sjellja jonjerëzore dhe poshtëruese gjatë bastisjes të shtëpisë dhe personave, e deri te keqpërdorimi i instituteve juridike siç është paraburgimi në funksion të nxjerrjes të pranimit (sidomos rasti Çukleva).

Policia nuk përpiqeshte që të nxjerr pranim vetëm për vepra të rënda penale (si te të akuzuarit për “terrorizëm”, apo madje edhe dëshmitarët – për shembull, dëshmitari kryesor për rastin “Sopot” i cili nuk ishte akuzuar) por edhe në raste të vjedhjeve të thjeshta. Në Komitetin e Helsinkit si raste të torturës janë regjistruar rastet e: Skender Sadikoviç që është rrahur në oborin e tij para tre fëmijëve të tij të mitur dhe më shumë fqinj, e pastaj është arrestuar në stacionin policor ku i është nënshtruar një rrahjeje të forte në të cilën kanë marr pjesë 6 polic, me qëllim që të nxirret pranim i fajit për vjedhjen e kryer në “Shën Petkë” në Bediçe ku ka humbur kasaforta me paratë nga shitja e qirinjve. Gjatë rrahjes, policët kanë përdorur sopatë dhe e kanë goditur të brinjët dhe te veshkët. Senad Rustemovski dhe Ejvas Sherifovski nga Prilepi dhe Jashar Ramadan nga Manastiri në datë 8.02.2003 janë arrestuar në stacionin policor në Prilep për shkak të identifikimit ku janë ofenduar, rrahur dhe keqtrajtuar nga ana e pesëmbëdhjetë policëve. Pas 4 orësh janë detyruar që të nënshkruajnë deklaratë se nuk kanë asnjë vërejtje për sjelljen e policisë dhe më pastaj janë liruar. Forumi për të drejtat e romëve “ARKA” nga Kumanova ka njoftuar se me datë 02.04.2003 reth orës 16.30 te përmendorja Kosturnica në Kumanovë, dy persona të përkatësisë etnike rome janë rrahur nga ana e policisë. Sipas informacioneve për “ARKA”, kësaj ngjarjeje i ka paraprirë përleshje ndërmjet personave të dëmtuar dhe rojes të përmendores Kosturnica, i cili është munduar t’i largojë sepse kanë luajtur basketboll. Pasiqë nuk ka patur sukses, roja ka thirr policinë e cila ka ardhur menjëherë dhe ka filluar që t’i rrahë. Si pasojë e rrahjes, një person ka fituar lëndime të dukshme në pjesën e shpinës, duarve dhe këmbëve. Ai ka kërkuar ndihmë mjekësore dhe ka marrë vërtetim mjekësor. Personi tjetër, i mitur, është rrahur me grushta por nuk ka patur shenja të dukshme të lëndimeve, por gjithashtu ka shkuar në mjek. Dalibor Vlačoski është pa dokument me shkrim dhe arsyetim është arrestuar në SP Krushevë përmes garazhave, dhe jo nga hyrja kryesore “që të mos shoh gjithë qyteti se si e dërgojnë në stacion”. Drejtë garazheve është drejtuar edhe babai i tij, që të shoh se çfarë po ndodh me djalin. Pas daljes nga policia, te Dalibori është konstatuar lëndim i rëndë i syrit të zi, me çrast ai është hospitalizuar dhe ka mbetur 9 ditë në mjekim spitalor në klinikën e syve, kurse te babai i tij është konstatuar frakturë e tre brinjëve (nga brinja e gjashtë në brinjën e tetë) nga ana e djathë e gjoksit. Mitko Zatkovski në datë 28.05.2003 në orët e hershme të mëngjesit është vizituar nga tre policë të cilët e kanë njoftuar se kanë urdhër për ta sjellur me përdorim të forcës si dëshmitar në gjykatë – dokumenti nuk është treguar. Pasi është shtrënguar fizikisht, me çrast ka marrë edhe lëndim trupor, me bluzë me mëngë të shkurtra është dërguar në stacionin policor Gjorçe Petrov por, në vend se prej atje të dërgohet në Gjykatë në Vinicë, është lënë të shkoj në shtëpi.

Ajo që shqetëson më seriozisht është se shteti, edhe krahas reagimeve të shumta (si të mediave ashtu edhe të organizatave joqeveritare) nuk ka ndërmarrë aktivitete përkatëse për tejkalimin e gjendjeve. Përkundrazi, fitohet përshtypja se sidomos policia vazhdimisht e rrit numrin e rasteve të tilla, se nuk ka sanksionim të brendshëm të policëve (për sanksionim gjyqësor nuk bëhet fjalë), e madje Policia vepron me vetëdije në mbulim me vetëdije të policëve të tillë (që i referohet të gjithë rasteve të përmendura). Kontrolli i brendshëm në Ministri për tejkalime të tilla të ngjajshme është pa pjesëmarrjen e qytetarëve, dhe karakterizohet me solidaritet kolegial. Njësia për standard profesional sipas rregullit “u beson” vetëm deklaratave të policëve të përfshirë, pa i përfshirë fare të dëmtuarit në hetim. Në një rast, policia vazhdimisht ofron që të bëhet njohja e policëve tjerë (vetëm jo të atyre që janë përfshirë). Në rast tjetër mohon me shkrim ekzistimin e rastit të torturës dhe krahas ekzistimit të dokumentacionit nga Ministria e mbrojtjes dhe nga Avokati i popullit për rastin. Reagim shumë i shpeshtë i policisë, kur thirren që të japin informacion gjatë ekzistimit të dyshimit se është kryer akti i keqtrajtimit fizik (zakonisht kur lëndimet janë

Komiteti i Helsinkit edhe njëherë thekson se të drejtat e njeriut nuk mund të jenë të mbrojtura pa ekzistimin e një policie efikase, të trajnuar, të organizuar dhe përgjegjëse.

Edhe njëherë ju përkujtojmë në nenin 1 nga Ligji për punë të brendshme, sipas të cilit, detyra kryesore e policisë është “mbrojtja e jetës, sigurisë personale dhe pronës të qytetarëve” dhe “mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit”, si dhe ajo se të dyshuarit, akuzuarit dhe të dënuarit janë gjithashtu qytetarë...

Komiteti i Helsinkit i mbështet ndryshimet në përbërjen e policisë në drejtim të pasqyrimin më real të karakterit multi-etnik të shoqërisë, si jashtëzakonisht të rëndësishëm për kryerjen e duhur të detyrave dhe si bazë për kthimin e besimit të qytetarëve. Megjithatë, këto ndryshime, në asnjë rast nuk mund të kryhen në mënyrë që do të thotë anashkalim të procedurave, rregullave dhe kriterëve.

I kushtojmë sidomos rëndësi mungesës të kontrollit përkatës të brendshëm dhe të jashtëm të punës të policisë dhe dispozitave ligjore dhe keqpëdorimit të detyrës zyrtare.

### 3.2 Gjyqësia dhe të drejtat e njeriut

Edhe vitin e kaluar ka vazhduar procesi i erozionit të dinjitetit të gjyqësorit si pushteti i tretë i pavarur. Edhe pse ishin bërë hapa të qartë përpara në drejtim të pavarësisë (me hyrjen në fuqi të ligjit të ri për buxhetin e pavarur gjyqësorë), në aspekt të pavarësisë dhe paanshmërisë nuk janë bërë zhvendosje domethënëse pozitive.

Përzgjedhja e gjykatësve dhe prokurorëve publik është ende nën ndikim të drejtëpërdrejtë të partive politike në pushtet (përzgjedhjen e bën Kuvendi i Maqedonisë) dhe pushtetit ekzekutiv (sidomos Ministria për drejtësi dhe Ministria për punë të brendshme). Çdo pushtet i ri përpiket që të instrumentalizojë gjyqësorin përmes “instalimit” të kuadrove të vërtetuara partiake në gjyqësor, e sidomos në vendet kryesore siç janë Këshilli gjyqësor republikan, Gjykata supreme, Gjykata kushtetuese dhe vendet e kryetarëve dhe vendet tjera në gjykatat tjera, si dhe në Prokurorinë publike.

Edhe gjatë vitit 2003, gjykatat dhe gjykatësit janë ekspozuar në presion të vazhdueshëm nga ana e segmenteve tjera të pushtetit (sidomos atij ekzekutiv) dhe në më shumë drejtime dhe në mënyra të ndryshme është bërë sulm i drejtëpërdrejtë mbi pavarësinë e tyre organizative

---

të dukshme, apo ekziston dokumentacion mjekësor) është se ka ardhur deri te vetëlëndimi i të dëmtuarit. Krijimi i një trupi efikas për luftë kundër tejkallimit të kompetencave policore imponohet si prioritet.

dhe funksionale.<sup>33</sup>

Pavarësisht nga idealet e ndarjes të pushtetit në ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, gjykatësit janë më shumë apo më pak kuazi – nëpunës shtetërorë dhe në rrugë të gjatë rrallëherë e kundërshtojnë pushtetin. Ndryshimet që përgatiten në procedurën penale si përgjigje ndaj kërcënimeve të kriminalitetit të organizuar dhe korrupsionet (masat e posaçme hetimore, mbrojtja e dëshmitarëve etj) janë në funksion të kontrollit më efikas të kriminalitetit, por nuk kushtojnë kujdes të veçantë për të drejtat e të akuzuarit dhe të drejtës të privatësisë. Sidomos shqetëson dhe Plani më i ri i veprimit për luftën kundër krimit të organizuar, dokumenti në të cilin instistohet në bashkëpunim të ngushtë me policinë, prokurorinë dhe gjykatat (që është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare me të cilin sigurohet gjykim feri dhe i paanshëm).

Në disa raste gjykatësit kanë treguar njohje shumë të dobët të rregullativës ndërkombëtare dhe nacionale të lidhur me liritë dhe të drejtat e njeriut, dhe jo vetëm që nuk paten sukses që të realizojnë rolin e tyre të mbrojtjes më të lartë të këtyre të drejtave, por janë paraqitur edhe si shkelës të drejtëpërdrejtë të të drejtave të qytetarëve.<sup>34</sup>

Shkelja e lirive dhe të drejtave të njeriut, në lidhje me realizimin e standardeve minimale dhe garancive të parapara në nenin 5 dhe nenin 6 nga Konventa Europiane për të drejtat e njeriut, mund të lokalizojmë në të gjithë fushat dhe në të gjithë nivelet e realizimit të pushtetit gjyqësorë.

---

33 Do të përmendim rastin me gjykatën në Gostivar, kur ministri për punë të brendshme hapur përzihet në vendimin e gjykatësit që të mos përcaktojë masën paraburgim për të dyshuarin që ka rezultuar në ndrrimin e gjykatësit dhe marrjen e vendim të kundërt me atë të marrë nga ai.

34 Indikative për mosekzistimin e vetëdijes për të drejtat e njeriut te gjykatësit është edhe bërja e të shurdhërit për deklaratat për torturë dhe trajtimin jonjerëzor, dhe neglizhimi i praktikës të bazuar mbi KEDNJ, se barra për sigurimin e një sqarimi të pranueshëm për shkaktimin e dëmit bie te pushtetet, e jo te mbrojtja (në rastet kur ndonjë person është vendosur në paraburgim policor në gjendje të shëndetshme, por gjatë lëshimit është vërtetuar se është lënduar). Shembull më eklatant ishte të bërit të shurdhër të gjykatës në procesin kundër Selam Selami, I cili “zhduket” pasiqë drejtohet drejtë gjykatës që të kërkojë urdhërin për bastisje në shtëpinë e tij. Mbrojtja posedonte shumë dëshmi mjekësore, duke përfshirë edhe njoftimin e nënshkruar nga drejtori i Byrosë për siguri publike (nga data 29.08.2002) “Selam Selami ndodhet në qendrën klinike në Shkup, për shkak se ka gjakderdhje në tru, që është paraqitur si rezultat i hipertensionit, të shkaktuar nga arsytet psikosomatike. As prokuroria, as gjykata nuk kanë ndërmarrë asnjë masë që do të sillte deri te gjetja dhe ndëshkimi i personave përgjegjës. Në disa procese të tjera gjyqësore, kundër personave të cilët janë dënuar për veprën penale terrorizëm, mbrojtja ka nxjerrë deklaratat se dëshmitë kryesore në të cilat bazohet aktakuza janë deklaratat të cilat janë nxjerrë me forcën policore. Për me tepër, deklaratat e të akuzuarit Avni Ajeti (që është dhënë si dëshmi kundër komandantëve “Çakalla dhe Xhejmi Shej”) si dhe të dëshmitarit Ramadan Bajrami (rasti “Sopot”) janë mohuar në shqyrtimin kryesorë me arsytimin se janë dhënë nën detyrimin policor. Edhe pse gjykatës i janë paraqitur dëshmi përkatëse mjekësore për lëndimet e shkaktuara gjatë paraburgimit, e madje edhe gjurmë nga lëndimet e fitura të paraqitura në shqyrtimin kryesor (në rastin e Avni Ajetit), si indicje për arrestimin e kundërligjshëm dhe mbajtjen e kundërligjshme nga ana e policisë, gjykatat janë treguar të shurdhëra në pretendimet për torturë dhe veprim jonjerëzor dhe poshtërues. Gjykatat themelore nuk kanë kërkuar që të bëhet hetimi efikas zyrtar që do të duhet të sillte deri te vërtetimi i gjendjes faktike në lidhje me indicjet se dëshmitë (deklaratat) janë marrë me shkeljen e të drejtave të njeriut, dhe kanë sjellë aktgjykime ndëshkuese (në rastin “Sopot” dhe rasti “Ajeti, Çakalla, ‘Shej’...”) duke iu dhënë besim deklaratave të para të dhëna para gjykatësit hetues.

- 1. Gjykatat edhe në vitin 2003 në përgjithësi kanë dështuar në mbrojtjen e të drejtës
- të pakontestuar të lirisë dhe sigurisë të personalitetit si në aspekt të kontestimit të
- ligjshmërisë dhe kontestimit të lirisë, ashtu edhe në aspekt të përcaktimit të masës
- paraturigim dhe kontestimit të ligjshmërisë të tij.<sup>35</sup>
- 2. Gjykatat nuk janë përgjigjur në kërkesën për përfundimin e procedurave në afat të
- arsyeshëm.<sup>36</sup>
- 3. Barazia e mbrojtjes dhe akuzës dhe barazia e armëve të cilat ata mund të shfrytëzojnë

35 Gjykatësit e injorojnë prezumimin e pafajsisë si dhe faktin se barra e të dëshmuarit të bazueshmërisë të arsyeve është e atyre që kanë marrë lirinë. Gjykatësit përcaktojnë paraturigim maksimal (30 ditë) edhe në rastet kur një masë e tillë e fortë nuk është e nevojshme, pa dhënë paraprakisht arsyetim për arsyet thelbësore juridike dhe **faktike** për privimin nga liria, të cilat më vonë do i mundësonin personit që të kontestojë ligjshmërinë e paraturigimit. Zakonisht gjykata vetëm thirret në dispozitën formale pa theksuar paraprakisht edhe arsyet e bazuara mirë faktike. Gjykatësit shumë shpesh e vazhdojnë paraturigimin automatikisht, duke përshkruar pretendimet nga vendimet e mëparshme, pa shqyrtuar nëse akoma ekzistojnë faktikisht arsyet për paraturigim. Për shembull, arsyetimi i vendimit për vazhdimin e masës paraturigim edhe për 30 ditë kundër Orce Milenkovskit, Tome Bajdevskit, Dragan Zdravkovskit dhe Sasha Stojanovskit nga data 10.10.2003 është përshkruar fjalë për fjalë nga vendimi i datës 07.11.2003. Në vendimin që nuk është arsyetuar faktikisht, këshilli gjyqësorë ka shkuar deri atje që lartësia e dënimit të paraparë për veprën penale për të cilën dyshohet, **në vete**, ka theksuar si bazë për vazhdimin e masës paraturigim.

Në vitin e kaluar janë vërejtur më shumë raste të paraturigimit ekstensiv, në disa raste edhe selektiv, ndaj opozicionerëve apo anëtarëve të mëparshëm të UÇK/AKSH. S. Shukleva, anëtarë i lartë i partisë opozitare VMRO-DPMNE është paraturigosur 4 muaj pa argumentim prej të cilit do të rridhte domosdoshmëria e paraturigimit. Deputeti i mëparshëm Amdi Bajram, është mbajtur në paraturigim 9 muaj (pasiqë këshilli penal ka shfuqizuar vendimin e gjykatësit hetus për lirimin nga paraturigimi), pavarësisht nga ajo që është ofruar kaucion që ka tejkaluar shumë për të cilën është akuzuar Barjami. Krenar Osmani ishte 11 muaj në paraturigim (në fund edhe duke u bazuar në dënimin e shqiptuar në fillim prej 6 vitesh që më vonë është shfuqizuar) që më vonë prokuroria të tërhiqet nga rasti për shkak të mungesës të dëshmitarëve. I akuzuari, dhe dëshmitari potencial, Safet Beluli është mbajtur në paraturigim 12 muaj, kurse procedura është ndërprerë për shkak të mungesës të dëshmitarëve. Gjykata ka marrë aktgjykimin lirues për shkak të mungesës të dëshmitarëve në rastin e Vullnet Jazimi, duke ndryshuar aktgjykimin e parë me të cilin Jazimi është shpallur fajtor dhe është dënuar me dënim me burg me kusht, me të cilën kanë dashur që të “mbulojnë” shtatë muajt që Jazimi i ka kaluar në paraturigim.

36 Kohëzgjatja shumë e gjatë e procedurave është lidhur me periudhat e gjata të jo aktivitetit në procedurat që janë si rezultat i: jo përditësimit, kërkesa jo të rregulluara të ekspertëve, dërgesë jo e rregulltë dhe të ngjajshme. Kohëzgjatja e procedurave është e lidhur edhe me përgatitjet e bëra në procedurën parahetimore. Në fakt, një pjesë e aktakuzave janë ngritur pa material të grumbulluar të mjaftueshëm, që nënkupton nevojën për grumbullimin e tij gjatë kohëzgjatjes të vetë procedurës.

Për shembull, Gjykata Themelore Shkupi I –Shkup ende nuk vendoste për kërkesën për vërtetimin e ligjshmërisë për privimin nga liria të z.Beqa për shkak të heshtjes të Policisë që nga data 09.07.2002 dhe kur më në fund ka ardhur përgjigje nga MPB (“se policia kriminalistike pranë MPB të RM – Shkup nuk ka bërë privimin nga liria të personit Muhaedin Beqa... e as që ka ndërmarrë masa dhe aktivitete ndaj personit të caktuar “?!) gjykata ka vendosur që të stërzgjasë rastin edhe krahas asaj që personi Muhaedin Beqa posedon njoftim deri te avokati i popullit, dërguar nga ana e Ministrisë të atëhershme për mbrojtje - prof. d-r Vlado Popovski, në të cilën është theksuar se personi Muhaedin Beqa, përndryshe kapiten në ARM, është arrestuar në Stacionin Policor Avtokomandë. Gjithashtu, Gjykata Themelore Kumanovë ende nuk ka marrë vendim për kërkesën për shqyrtim të ligjshmërisë të privimit nga liria të personit Jovançe Lazorovski, të dorëzuar në datë 7.08.2003. Edhe urgjenca e dërguar deri te Kryetari i Gjykatës Themelore Kumanovë (në datë 26.09.2003) ka mbetur pa përgjigje.

Sidomos eklatant është shembulli me procedurën e kompenzimit të drejtë në kontestin gjyqësor të Jadranka Ivanovskës nga Shkupi që po zhvillohet tashmë 16 vite dhe akoma nuk është përfunduar, që në vete paraqet bazë për aplikim deri te Gjykata Europiane për të drejtat e njeriut në Strazburg.

- në procedurën gjyqësore janë shkelur në më shumë raste.<sup>37</sup>
- 
- 4. Është shkelur e drejta në mbrojtje dhe mbrojtje sipas përzgjedhjes personale,<sup>38</sup> si dhe e drejta e publikut në gjykim,<sup>39</sup> dhe gjykimi në mungesë vetëm në rethana të veçanta dhe me përjashtim.<sup>40</sup>
- 
- 5. Ndërmjet shkeljeve më të rënda të nenit 6 nga Koventa Europiane është mungesa e përkthyesit kompetent dhe profesional në rastet kur një nga palët (sidomos i akuzuari) nuk e njeh gjuhën në të cilën realizohet gjykimi. Gjykimi shumë shpesh nisët nga supozimi se njohja e gjuhës është e mjaftueshme.<sup>41</sup>

Aspekti i veçantë i gjyqësorit i parë nën prizimin e të drejtave dhe lirive të njeriut është kontrolli dhe ligjshmëria e tij në të punuarit. Në bazë të disa tërheqjeve të përfaqësueve të shoqatës të gjykatësve, në lidhje me kritikën e drejtuar nga ana e publikut, fitohet përshtypja se pavarësia e gjykatave në fakt interpretohet si papërgjegjësi, mosdhënie e llogarisë, jo

37 Në shumë rasti (për shembull rasti i Ljuben Paunovskit, mbrojtjes i është pamundësuar që të thirrë dëshmitarët personal, kundrejt numrit të madh të dëshmitarëve të ftuar nga ana e akuzës.

Vendosja jo e barabartë e mbrojtjes në lidhje me akuzën (kur pas saj qëndron Prokurori Publik) janë taksat e larta, pagesa për shqyrtim të dokumentacionit të grumbulluar në procedurën hetimore dhe ngritja e dokumenteve të caktuara.

E drejta e barazisë të mjeteve, si dhe e drejta e prezumimit të pafajsisë janë shkelur edhe në procedurat kundër anëtarëve të mëparshëm të UÇK dhe AKSH, ku prokuroria në mungesë të dëshmitarëve thirrej në “fakte notore”. Për shembull, në gjykimin kundër të akuzuarve për terrorizëm në Kumanovë, gjykata jo vetëm që nuk reagoi në fjalët përfundimtare të prokurorëve sipas të cilave është “fakt notor” se të akuzuarit “Çakalla dhe Xhejmi Shej” janë “terroristë të dëshmuar” (edhe krahas deklarimeve të mbrojtjes për shkelje të së drejtës të prezumimit të pafajsisë), madje edhe i vërtetoi duke dënuar të gjithë të akuzuarit nga shtatë vite burg. Gjykatat pranojnë pothuajse të gjithë dëshmitë e prokurorisë, pa dallim nëse të njëjtat janë fituar në mënyrë joligjore apo me shkeljen e të lirive dhe të drejtave të njeriut.

38 Në rastin e Ljuben Paunovski gjykatësja ka shkelur të drejtën e mbrojtjes duke caktuar mbrojtës sipas detyrës zyrtare (edhe pse i akuzuari kishte mbrojtësin e tij personal) i cili nuk kishte kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes duke patur parasysh kompleksitetin e rastit.

Nga ana tjetër, mbrojtësit sipas detyrës zyrtare ndahen në mënyrë restriktive te personat e varfër. Madje edhe në aksionin për hapjen e zyrave të veçante për ofrimin e shërbimeve pa pagesë të avokatit, të organizuar nga ana e Dhomës të Avokatëve në Republikën e Maqedonisë, e mbështetur financiarisht nga Qeveria Amerikane, me shumë gjasa është e vështirë që të arrihet deri te adresat e këtyre zyrave dhe emrat e avokatëve të angazhuar .

39 Në vendet më të vogla shumë shpesh shkilet parimi i publikut në gjykim me arsyetim se hapësira në gjykatore është e vogël. Gjykimet realizohen në hapësirë aq të vogël (saqë nuk ka vend as për anëtarë më të afërt të familjes të së akuzuarit. Për fat të keq, ende nuk është çrrënjësuar praktika e mbajtjes të gjykimeve në zyrat e gjykatësve. Gjykatat janë më shpesh jo transparente në aspekt të informacioneve për vendin dhe kohën e mbajtjes të gjykimit.

40 Në procedurat penale shumë shpesh shfrytëzohet gjykimi në mungesë (sidomos për veprat penale terrorizëm dhe rrezikim të sigurisë). Të akuzuarit shpallen si jo të disponueshëm (që për disa prej rasteve gjithashtu nuk është e saktë sepse disa prej tyre ndodhen në vetë sallën gjyqësore si pjesë e publikut të pranishëm në gjykim).

41 Kjo ndodh kur si të akuzuar paraqiten anëtarët e bashkësisë shqiptare të cilët e flasin gjuhën shqipe, megjithatë në nivel të pamjaftueshëm që të kuptojnë të gjithë akuzat dhe të marrin mënyrë të barabartë në procedurë).

transparencë dhe paprekshmëri e gjykatësve.<sup>42</sup> Dukshëm se duhet të punohet shumë në përforcimin e vetëdijes për përgjegjësinë e gjykatësve që është një kusht i domosdoshëm për sigurimin e gjykimit të drejtë.<sup>43</sup>

Në vitin 2003, Prokuroria Publike nuk arriti që në punën e saj të zbatojë standardet ndërkombëtare për liritë dhe të drejtat e njeriut. Në shumë raste kjo është paraqitur si shkelës i drejtëpërdrejtë i këtyre të drejtave apo si vëzhdues pasiv i shkeljeve të tilla nga ana e Ministrisë të punëve të brendshme, organet shtetërore. Prokuroria publike nuk ka marrë rol aktiv në zhvillimin e procedruave kundër pjesëmarrësve të Ministrisë për punë të brendshme në rastet e shkeljes të dukshme të ligjit<sup>44</sup> në rastet e tejkallimit të treguar të autorizimeve (në funksion të mbrojtjes të lirive dhe të drejtave të qytetarëve).<sup>45</sup>

---

42 Në këtë kontekst, është simptomatik njoftimi i Gjykatës kushtetuese (nga data 5.09.2003) deri te mjetet për informim publik në lidhje me valën e kritikave publike të drejtuara për punën dhe funksionimin e gjyqësisë. “Kremi” për gjykatën maqedonase (gjykatësit suprem, kryetarët e gjykatave të apelit, dhe kryetarët e gjykatave themelore) ka ardhur në përfundim se “shkatërrues” të gjyqësisë janë edhe ata të cilët ofrojnë “konceptin për zgjidhjen e lëndëve aktuale që gjykohen” dhe atë të cilët “bombardojnë me bomba pushtetin gjyqësorë”.

43 Shmangien e përgjegjësisë me shpalljen e gjyqit si jo kompetent kishim kur Gjykata supreme dhe Gjykata kushtetuese janë shpallur si jokompetente në rastin “banesa sociale” duke i lënë qytetarët pa udhëzim juridik se si të realizojnë të drejtën e garantuar me kushtetutë për ankesë, në lidhje me vendimin e Qeverisë për shfuqizimin e shpalljeve për “banesat sociale”. Shmangien e përgjegjësisë personale në lidhje me pasojat nga urdhërat e gjyqit, për shembull, kur gjykatësi hetues nga Gjykata themelore e Shtipit lëshojnë urdhër për bastisje të shtëpisë në të cilën nuk është theksuar se për cilën vepër penale bëhet fjalë as se cilat lëndë janë të rëndësishme për procedurën penale, kurse bastisja po realizohet në një adresë krejtësisht tjetër. Të treguarit nga jonë është injoruar nga Kryetari i Gjykatës themelore, kurse nga ana e gjykatësit hetues është komentuar në mënyrë arrogante si e “pakumtimtë” pa ofruar paraprakisht argumentet përkatëse.

Veçanërisht shqetësues është shmangia e përgjegjësisë në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Gjykatësit sikur harrojnë që kjo detyrë i mbetet gjykatësitë në rastet kur asnjë organ tjetër shtetëror nuk ndërmerr masa për ekzekutimin e vendimit. Për shembull, në Ligjin për kontestet administrative (neni 75), është parashikuar qartë detyrimi i Gjykatës administrative që të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme për “vendosjen e gjendjes të ligjshme”. Megjithatë, dukshëm e dekurajuar nga praktika, Gjykata supreme “ka ngritur duart” nga ky detyrim e madje edhe në Rregulloren e saj për punë nuk ka parashikuar asnjë mekanizëm përmes të cilit do të kujdesej për realizimin e vendimeve personale. Në atë mënyrë e drejta “zhvishet” (jus nudum), krijohen kushte që shteti të zbatojë vendimet gjyqësore në mënyrë selektive, respektivisht në vend të sundimit të së drejtës të krijohet – anarkija juridike

44 Edhe krahas dyshimeve të dukshme e të treguara për ngritjen e kallzimeve penale (neni 377 pg.3 nga KP Mosekzekutimi i vendimit gjyqësor) kundër të gjithë atyre personave të cilët vazhdojnë të zbatojnë në praktikë nenet e shfuqizuara nga Ligji për punë të brendshme dhe nga Rregullorja për kryerjen e punës të Ministrisë për punë të brendshme, Prokuroria publike nuk ka ndërmarrë asnjë veprim.

Prokuria publike nuk ka treguar interes më të madh as për rastin “Vreshtat e Reshtakut” dhe rolin e përfaqësuesve të Ministrisë për punë të brendshme në ekzekutimin e e shtatë shtetasve pakistanez, as në rastin e Muhadin Beqës dhe tejkallimet e treguara në kryerjen e detyrës zyrtare të anëtarëve të Ministrisë të punëve të brendshme.

45 Në kryerjen e rolit mbrojtës në lidhje me policinë, Prokuroria publike lejon përdorimin edhe të standardeve të dyfishta (gjatë tetë muajve gjykim para Gjykatës themelore në Veles, ku personi Spase Dimovski paraqitet në cilësi të të dëmtuarit, prokuroria në fjalët përfundimtare tërhiqet nga ndjekja e mëturjeshe të policëve të akuzuar duke i thirrur pikërisht në Ligjin për amnesti. Në këtë rast, janë amnestuar katër anëtarë të policisë të cilët në datë 11.08.2001 në rrugën lokale në f.Rashtan – f.Buzallë kanë gjuajtur pa parë 54 plumba në traktorin në të cilin është gjendur i dëmtuari, i cili vetëm me fat ka patur sukses që të mbijetojë (për çfarë janë grumbulluar të gjithë dëshmitë e nevojshme) kundrejt hetimit të vazhdueshëm në procedurën për Krenar Osmanin ku (nuk zbatohet deri në fund Ligji për Amnesti dhe krahas asaj që nuk ka asnjë dëshmi valide kundër të akuzuarit; Zëvendës prokurorit themelor publik nga Velesi i nevojiteshin pothuajse dy vite që të dorëzojë Propozim për ndërmarrjen e veprimeve



Në marrëdhëniet e vendosura të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit ndërmjet Prokurorisë publike dhe gjykatave kanë të bëjnë me një numër të vogël të akteve akuzuese të cilat nuk përmbushin kërkesat elementare procedurale dhe asnjëherë nuk mund të konsiderohen si të mjaftueshme për incimin e procedurës gjyqësore.<sup>46</sup>

*Komiteti i Helsinkit konsideron se në Republikën e Maqedonisë as në vitin 2003 nuk janë siguruar kushte për mbrojtje përkatëse të lirive dhe të drejtave të njeriut në kuadër të sistemit gjyqësorë. Në punën e gjykatave edhe më tutje nuk implementohen as standardet minimale (të garantuara në Konventën Europiane për të drejtat e njeriut. Gjykatat nuk janë të pavarura, nuk janë të paanshme dhe nuk sigurojnë procedurë fer dhe të drejtë nën kushte të barabarta për secilin qytetar. Ndikimi i pushtetit ekzekutiv edhe më tutje është dominant dhe promovon modusin partiak-politik në llogari të atij ligjor-juridik. Në këtë mënyrë devalvohet një nga shtyllat kryesore të konceptit të të drejtave të njeriut.*

## ● 4. Personat e ● shpërngulur brenda ● vendit dhe refugjatët

Dy vite pas përfundimit të konfliktit ende nuk është zgjidhur problemi me personat e shpërngulur jashtë vendit. Momentalisht në territorin e Republikës të Maqedonisë ka zyrtarisht mbi 1.500 persona të shpërngulur brenda vendit në qendra kolektive) dhe numër jo të evidentuar të personave të shpërngulur të cilët janë të vendosur te familjarët apo vetë kanë zgjedhur statusin e tyre.

Aktivitetet e Qeverisë dhe Ministrisë për punë dhe politikë sociale janë të drejtuara

---

të caktuara hetimore (30.07.2003), në bazë të së cilave duhet të vendoset nëse do të parashtrohet propozim akuzë për rastin kur në datë 9.08.2001 është sulmuar shtëpia e Sabir Vejselov me çrast është qëlluar djali i tij Tafik Vejselov i cili ka vdekur në vendin e ngjarjes. Policët e përmendur më parë në rastin me Spase Dimovski kanë marrë detyrë që të jenë përfshirë në sigurimin e pikës të vnedosur pas vrasjes të të miturit Tafik

46 Aktakuza kundër Ljuben Paunovskit, për shembull, ka dispozitiv dhe arsyetim të cilat praktikisht janë të njëjta fjalë për fjalë që duhet të konstatohen nga ana e Gjykatës në shqyrtimin e aktakuzës të dëshmime më të komplikuar në bazë të dëshmimeve deri te të cilat ka ardhur deri te përfundimet e paraqitura në Dispozitiv; situata është e ngjajshme me aktakuzën në rastin kundër Selami Selamit ku është parë qartë se Prokuroria duke mos patur se çfarë të theksojë në Arsyetim – krahas përmirësimit të përfundimeve nga Dispozitivi, i ka theksuar te informacionet e përgjithshme për Selamiun (ku ka lindur, adresa e jetesës etj).

drejtë një opsioni të vetëm, rikthim me forcë.<sup>47</sup>

Sipas reagimeve të personave të shpërngulur brenda vendit pavarësisht nga prejardhja e tyre etnike, traumat e vuajtura, kërcënimet, humbjet e vendeve të punës, pamundësia që të sigurojnë ekzistencë për shkak të shtëpive dhe shitore të shkatërruara dhe të vjedhura, mospasja e kushteve që të ndiqet mësimi në shkollë, shtëpitë jo të ndërtuara, (edhe ata që janë të rindërtuara nuk mundësojnë kushte elementare për jetesë që është vërtetuar nga monitorimet e Komitetit të Helsinkit për të drejtat e njeriut për jetën, pronën dhe sigurinë e tyre janë pikërisht arsyet që pretendimet e Qeverisë i bëjnë të pabazuara dhe arsye se pse këto njerëz nuk kanë për qëllim që të kthehen edhe nëse rinovohen shtëpitë e tyre.

Në aktivitetet e tyre në hapësira ku zhvillohet konflikti në vitin 2001, Qeveria jo vetëm që nuk respekton ligjet nacionale,<sup>48</sup> por nuk respekton edhe standardet e pranuar ndërkombëtare<sup>49</sup> dhe përpiqet me ndërmarrje të masave kufizuese, përmes shfuqizimit të ndihmës sociale të këtyre personave, përmes kushteve të këqija për jetesë në qendrat kolektive, që t'i motivojë që të kthehen në shtëpitë e tyre.

Edhe në rastin “i harruar dhe i lënë pas dore” një pjesë e refugjatëve nga Kosova, që në Maqedoni kanë ardhur që nga viti 1999, për Qeverinë zgjidhja më e dëshiruar është rikthimi. Viti që kaloi karakterizohej me aktivitete të cilat theksojnë se bashkësia ndërkombëtare, e para së gjithash Qeveria, i shmangen përgjegjësisë që kanë në lidhje me refugjatët e që rrjedh nga dokumentet ndërkombëtare që shteti ka ratifikuar dhe për të cilat sikur harrohen se paraqesin pjesë të legjislacionit nacional.<sup>50</sup>

---

47 Kjo është vërtetuar me Përfundimin e Qeverisë (17.02.2003) për rikthim të personave të shpërngulur brenda shtetit në Tetovë dhe në fshatrat tetovare, si dhe me njoftimet e Ministrisë për punë dhe politikë sociale nga muaji Qershor 2003, me të cilat “ndërpriten kushtet për shfrytëzimin e shërbimeve në qendrat kolektive” me ndërprerjen e njëkohshme të ndihmës në ushqim. Të gjithë këto aktivitete janë bazuar në kushtin (pas shikimit të Qeverisë) se nuk ekzistojnë më arsyet të cilat kanë qënë bazë që këto persona të fitojnë statusin e personave të shpërngulur brenda vendit. Kundrejt kësaj nuk janë siguruar kushtet minimale për kthimin e njerëzve në vendin e mëparshëm të tyre të jetesës. Nuk bëhet rikonstruktiv i tërësishtëm i shtëpive të shkatërruara, nuk garantohet siguria në vendin e jetesës, nuk reagohej në dhunën mbi popullsinë e rikthyer, nuk sigurohet ndihma material dhe financiare e të rikthyerve.

48 (sipas të cilave ekziston përgjegjësi e shtetit që të kompensojë të gjithë dëmet e shkaktuara nga veprimet e saj – neni 166 pg.1 Ligji për marrëdhënie detyrimore)

49 Nuk respektohet parimi i moskthimit (non-refoulement), nuk mundësohet pjesëmarrja e personave të shpërngulur brenda vendit në marrjen e vendimeve të cilat i referohen rikthimit, shpërnguljes dhe miratimit të përgjithshëm të vendimeve për jetën e tyre dhe të ardhmen (Parimet udhëheqëse për shpërnguljen e brendshme, t. 28. pg. 2).

50 Në Republikën e Maqedonisë ka reth 2700 persona përkohsisht të përkujdesur humanitar (rom, anashkali, egjiptian nga Kosova, Serbia dhe Mali i Zi) prej të cilave gjysma janë vendosur në qendra kolektive kurse numri më i madh në kampin në Shuto Orizar ndërsa të tjerët në akomodim privat. Fati i këtyre personave ishte ndryshimi në momentin kur me vendim të njëanshëm të Qeverisë në bashkëpunim me UNHCR e kanë mbyllur kampin edhe krahas revoltit të shprehur të përfaqësueve në vetëqeverisjen lokale Shuto Orizar dhe trupit përfaqësues i refugjatëve. Praktikisht këto persona me këtë veprim qeveritar kanë qëndruar ilegalisht në shtet sespe nuk kishin më adresë të jetesës apo qëndrimin që ishte kusht për vazhdimin e e statusit të mëparshëm ekzistues të personave të përkujdesur humanitar përkohësisht. Me këtë, këto persona nuk mund të rirregjistrohen. Revolti ishte hetuar me shpërnguljen e vetëorganizuar të reth 700 romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në kalimin kufitar Mexhitli në kufirin Maqedonas – grek në datën 19.05.2003. Përplekja për jetë më të mirë vazhdoi me kërkesat e Republikës të Maqedonisë që të lëshojë këto persona të kërkojnë azil në një prej shteteve perëndimore

Qeveria dhe UNHCR i kanë vendosur këto persona në opsion të vetëm për zgjidhjen e fatit të tyre apo të dorëzojnë kërkesë për fitimin e azilit apo të kthehen në Kosovë.<sup>51</sup>

Ky ultimatum është në kolizion me vullnetarizmin gjatë aplikimit për azil dhe vullnetarizëm për kthim/rikthim në vendin e origjinës. Kthimi në Kosovë është zgjidhje tërësisht e papranueshme dhe situatë në vend të origjinës për këto persona nuk është ndryshuar dhe siguria nuk është garantuar. Opsioni i parë – dorëzimi i kërkesave për azil është praktikisht i porealizueshëm duke patur parasysh praktikën e shkurtër që Republika e Maqedonisë e ka parasysh në aspekt të zgjidhjes të rasteve në këtë fushë, sidomos për shkak të dispozitës ligjore që thekson skepticizëm në zgjidhjen pozitive të kërkesave për azil.<sup>52</sup> Aspekt tjetër që gjithashtu nuk jep besim në vendosjen pozitive, evident është numri ulët i rasteve të zgjidhura pozitive pas kërkesave për fitimin e azilit. Me këtë lidhet edhe pamundësia që të shqyrtohen opsionet e përgjegjësise primare të pushteteve në Sërbi dhe Mal të Zi për shpërnguljen e popullsisë të tyre (në këtë rast rom, ashkali, egjiptian – RAE) në territoret që nuk janë përfshirë me krizën, mosrespektimi i parimit të solidaritetit nga ana e bashkësisë ndërkombëtare në rastet e largimeve masive të cilat janë të parapara me Deklaratën për azil territorial të OKB nga viti 1967, por edhe me vendimin e Bashkimit European nga viti 2001 për personat që janë nën mbrojtje të përkohshme.

*Komiteti i Helsinkit e përkujton pushtetin se personat e shpërngulur brenda vendit dhe refugjatët paraqesin grup veçanërisht të ndjeshëm të drejtat e të cilëve sipas rregullit tashmë janë shkelur apo shumë lehtë mund të lëndohen. Përgjegjësia e shtetit në mbrojtjen e këtyre grupeve është theksuar, sidomos në kushte të vazhdimit të gjatë kohor të situatës që ka sjellur deri te shpërngulja. Përgjegjësia e shtetit është veçanërisht e madhe në kushte kur ajo paraqitet si shkaktar kryesor në shpërnguljen e njerëzve. Asnjë vnedim që i referohet personave që janë shpërngulur brenda vendit nuk duhet të behet pa bashkëpunimin e tyre përkatës dhe aktiv dhe zbatimin e parimeve të marrëveshjes dhe vullnetarizimit. Çdo veprim i dhunshëm paraqet akt të shkeljes të mëtutjeshme të lirive dhe të drejtave të njeriut.*

---

europiane kur ajo edhe pas aq vitesh nuk u ka siguruar mundësi për jetesë me dinjitet dhe normale. Në kushte tërërisht jo të përshtatshme për jetesë, pa ndihmë elementare, refugjatët mes të cilëve ka patur edhe numër të madh të grave, fëmijëve, të moshuarve, janë përpjekur që të kthejnë vëmendjen e publikut ndërkombëtar drejtë pozitës të tyre. Publiku ndërkombëtar është treguar tërësisht i shurdhër për krizën humanitare që ka zgjatur tre muaj (deri në datën 9.08.2003). në mungesën e dukshme të interesit të bashkësisë ndërkombëtare nëse këto njerëz mbijetojnë apo jo, ata u pajtuan që ata sërish të vendosen në qendrën kolektive Katllanovë, hotelin Jug turist dhe shtëpitë private, Komiteti i Helsinkit apelonte deri te Qeveria dhe UNHCR për sigurimin e kushteve më të përshtatshme për jetesë nga ato që janë dhënë, sepse përpjekjet dhe premtimet për përmirësimin e jetës aspak nuk janë bërë dhe realizuar.

51 Sipas të dhënave të fundit për azil kanë aplikuar 2200 nga refugjatët në Republikën e Maqedonisë. Numër më i vogël tashmë është pajtuar vullnetarisht të kthehet në territorin e Sërbisë dhe Malit të Zi.

52 Sipas Ligjit të ri për azil dhe mbrojtje të përkohshme, neni 29/1-3, gjatë vlerësimit të kërkesës për azil nëse vërtetohet se personi mund të kërkojë mbrojtje në pjesë tjetër të shtetit shtetas i të cilit është “ndjekja është kufizuar vetëm në pjesë të territorit të shtetit, shtetas i të cilit është kërkuesi, apo nëse është pa shtetësi në të cilin ka patur vendbanim të zakonshëm dhe ekziston mundësia për mbrojtje efektive në pjesë tjetër të shtetit, përveç nëse duke patur parasysh të gjithë rethanat nuk mund të pritet që personi atje të kërkojë mbrojtje” kërkesa e tij do të refuzohet.



## 5. Liria e të shprehurit dhe mediat

Vlerësimi i përgjithshëm është se në vitin 2003 ka tendencë të përmirësimit të gjendjes në media krahasuar me periudhën e konfliktit gjatë vitit 2001 kur kishte rënie drastike të standardeve të gazetarëve të numri më i madh i mediave në Republikën e Maqedonisë.

Gjatë vitit 2003 mediat përpiqen që të bëhen aktor aktiv në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut. Në disa emisione bëhen diskutime për shkeljen e të drejtave dhe problemeve me mbrojtjen e tyre, përpunohen rastet specifike të shkeljeve thelbësore të të drejtave të njeriut, dhe, madje fillohen veprime të “telefonëve të hapur” deri te redaksite, përmes të cilave qytetarët mund të informojnë për rastet dhe përvojat personale. Në një numër të madh të rasteve, publiku ka marr informacione përkatëse dhe ai ishte mobilizuar në funksion të kryerjes të presionit mbi organet shtetërore që të marrin hapa përkatëse me qëllim të mbrojtjes të të drejtave të qytetarëve. Mediat kanë patur rol veçanërisht pozitiv në vitin e kaluar, në prezantimin e të dhënave për shkeljen e të drejtës për mjedis të shëndosh jetësorë.<sup>53</sup> Kthimi dominant ndaj marrëdhënieve ndëretnike zëvendësohet me një përfshirje të zonave të ndryshme nga fusha e të drejtave të njeriut (të drejtat e fëmijëve, të grave të pakicave seksuale etj).

Është vërejtur sa më rrallë gjuhë e urrejtes, edhe pse mund të vërehtet se ende ekziston ndarja sipas vijave etnike kur raportohet për ngjarje kritike.<sup>54</sup> Qytetarët janë ekspozuar në

53 Rasti me shkritoren e plumbit nga Velesi; rasti i rrëshqitjes të tokës në lagjen Ramina - Veles; rrëshqitja e zgjyrës nga minierat e Zletovës; prishja e ekuilibrit ekologjik dhe sigurisë të qytetarëve me ndërtimin jo të duhur në Shkup (në rastin Trnodol).

54 Kjo vërehej kur mediat kanë njoftuar për problemet me arsimin e mesëm, ku gazetarët kanë marrë më shpesh anë – vendosin në rol të mbrojtësve të kauzës maqedonase apo shqiptare. Gjithashtu, në fillim të vitit, në mungesë të rezultateve zyrtare nga regjistrimi për strukturën etnike të popullsisë, në të gjithë mediat kanë marrë një hov të madh spekulimet në lidhje me përfaqësimin në numra të komuniteteve të ndryshme etnike, që ka shkaktuar mosbesimin e zvogëluar dhe tensionet ndëretnike. Disa media në gjuhën maqedonase kanë vazhduar me informimin e njëanshëm dhe të anshëm për temat e ndjeshme siç është rasti Çemshevë, problemet me gjimnazistët në Kumanovë, dhuna ndërmjet nxënësve në Shkup, apo vazhdimi i spekulimeve për sëmundjen masive të nxënësve të Kumanovës në tekstin “Prej ku vjen helmi”? etj.

Jo më pak spekulime dhe njëanshmëri ishin të pranishme në media të caktuara në gjuhën shqipe që i referohen temës siç janë protestat reth mosrespektimit të Ligjit për amnesti, proceset rrjedhëse gjyqësore që zhvillohen kundër shqiptarëve etnike, e sidomos për shqyrtimin reth Ligjit për të drejtat e veçanta të forcave të sigurisë dhe familjet e tyre. Shembull i dukshëm për informimin selektiv paraqet gazeta “Fakti” që publikoi njoftimin e Komitetit të Helsinkit për rastin “Vreshtat e Reshtakut” por nuk e publikoi dhunën si precedentë që nuk guxon të përsëritet.

Por rasti “Komandant Çakall” ka hedhur dritë të re – për ndryshimin nga viti 2001, kësaj radhe edhe mediat në gjuhën maqedonase edhe ato në gjuhën shqipe ishin unik – ato dënuan aktin e kidnapimit të policëve nga ana “komandant Çakallës”.

informacione të njëanshme, shpesh të paverifikuara dhe në funksion të interesave të një partie politike. Karakteristikë (sidomos e mediave në gjuhën shqipe) është mungesa e çfarëdo kritike të përfaqësuesve të bashkësisë të tyre etnike në aspekt të shkeljeve të të drejtave të anëtarëve të bashkësive tjera etnike. Shpesh, në këto media (sidomos në gazetën ditore Fakti) anëtarët e bashkësisë të tyre etnike të cilët paraqesin një vetëkritike minimale apo problematizojnë ndonjë çështje, menjëherë etiketohen si “kaurr” (emër fytes për të krishterët).

Një nga problemet e mëdha në periudhën e kaluar është shkelja e prezumimit të pafajsisë nga ana e mediave. Të dyshuarit për vepra penale akuzohen dhe gjykohen para apo gjatë procedurave gjyqësore, kurse në rastet e lirimit të tyre, publiku nuk merr informacione përkatëse.<sup>55</sup>

Në vitin 2003 janë blerë dy gazetatat ditore të pavarura më me ndikim (Dnevnik dhe Utrinski vesnik) nga ana e koncernit gjerman VAC. Qeveria nuk ka reaguar në këtë (edhe pse mund të shtrohet pyetja për krijimin e monopolit mediatik nga ana e VAC). Nga ana tjetër, që duhet të përhëndetet, është nënshkrimi i Kartës të OSBE për respektimin e lirisë të shprehjes nga ana e VAC. Çështja e vendosjes monopolistike dhe mbështetja specifike nga ana e shtetit është vendosur në lidhje me Agjencinë informative maqedonase (AIM). Rasti ka kaluar në Gjykatën kushtetuese të Republikës të Maqedonisë. Partizimi i gjithçkaje që është nën ndikim të pushtetit ekzekutiv, është pasqyruar edhe në ndryshimet e bëra në RTVM, si media shtetërore. Ndryshimet kadrovike dhe organizative në masë të madhe e ndjekin direktivën partiake dhe krijojnë situatë të mosbesimit të qytetarëve ndaj informacioneve të fituara nga kjo shtëpi mediatike, respektivisht transformimi i saj në media që është e ngarkuar me propagandë partiake.

Megjithatë, specifikim të veçantë këtë viti është numri i madh të padive të dorëzuara kundër gazetarëve.<sup>56</sup>

Pesë raste të procedurave gjyqësore kundër gazetarëve e kanë tërhequr vëmendjen e Komitetit të Helsinkit:

- 1. Sonja Kramarska në nëntor të vitit 2003 është dënuar në Gjykatën themelore 1 në Shkup
- në dënim me të holla prej 20.000 denarë për shkak të një komenti të saj (përdorimi i
- fjalës “gënjën” për një deklaratë të deputetit Stojan Andov). Duke arsyetuar aktgjykimin,

---

55 Njoftimet në lidhje me rastin e Selam Selamit (të akuzuar për vrasjen e dy policëve) nuk ishin shoqëruar me njoftim përkatës për lirimin e tij.

56 Sipas njohurive të Komitetit të Helsinkit në 3 vitet e ardhshme janë parashtruar 125 padi penale kundër gazetarëve. Kjo mund të interpretohet në dy anë, nga njëra anë mund të nënkuptojë se vazhdon trendi që pushteti të instistojë të disiplinonë gazetarët, por nga ana tjetër e shtron pyetjen për etikën gazetareske dhe ofendimet dhe shpifjet si pjesë e raportimit të gazetarëve.

- Gjykata thekson se dënimi është shqiptuar për ta edukuar gazetaren.
- 
- 2. Zoran Markozanov – redaktor në javoren “Zum” është dënuar për veprën e njëjtë shpifje në dënim me burg prej 3 muajsh, kurse me kusht 2 vite.
- 
- 3. Bobi Siljanovski – gazetar në Radio Manastir dhe korrespondent i RTVM dhe javorja “Start” për shpifjen kanë marrë dënim prej 5 muajsh, kushtimisht 1 vjet dhe dënim me burg prej 21.000 denarë.
- 
- 4. Dragan Antonovski, gazetar i TV privat AI, është dënuar për shpifje me dënim me të holla prej 100.000 denarësh
- 
- 5. Mende Petkovski – nga Radio Manastiri dhe korrespondent në “Dnevnik” dhe TV Sitel për momentin gjykohet për shpifje të gjykatësit në Gjykatën e Apelit në Manastir. Gazetari e ka prezantuar lajmin se policia në Manastir në mënyrë të barabartë e zbaton ligjin (rregullat e qarkullimit) në lidhje me të gjithë, që shihet qartë në rastin e gjykatësit të Gjykatës të Apelit, automjeti i të cilit është larguar nga qarkullimi sepse ka vozitur pa targa regjistrimi. Lajmi i referohet ngjarjes që është jashtë veprimit zyrtar të gjykatësit të gjykatës të apelit, dhe i njëjti është përcjellur në disa media. Padia (nga prokurori publik) është dorëzuar kundër një gazetari, në një gjykatë kompetente gjykatësit e të cilës janë objekt kritike në shkrimet e mëparshme të gazetarit të njëjtë.<sup>57</sup>

Për çështjen e përgjegjësisë penale të gazetarëve për veprat shpifje dhe ofendim më së voni është zhvilluar debat publik me çrast Shoqata e gazetarëve ka akuzuar se ndryshimet në Kodin penal janë më të ashpra dhe nuk përputhen me rekomandimet e Këshillit të Europës dhe sidomos se ato propozohen pa pjesëmarrje të gazetarëve. Në fakt bëhet fjalë për mbajtjen dhe precizimin e përgjegjësisë penale për veprat shpifje dhe ofendim me ndryshimet e Ligjit për procedurë penale, dhe kërkesë nga ana e gazetarëve për statusin e tyre të privilegjuar në raport me qytetarët tjerë kur bëhet fjalë për këtë vepër penale. Komiteti i Helsinkut e mbështet idenë për heqjen e dënimit me burg për cilindo qytetar në bazë të këtyre veprave, por jo edhe heqje të përgjegjësisë penale dhe dënimit në të holla (që duhet të rritet në mënyrë drastike).

Problemi i veçantë në njoftimin mediatik paraqesin “kolumnistët”. Ato zakonisht janë persona të njohur nga rethe akademike apo politike të cilët kanë shkrime të rregullta pas mediave të shtypura. Në këto shkrime është shumë e shpeshtë gjuha e urrejtjes dhe ofendimet e hapura dhe vullgaritetet e drejtuara drejtë personaliteteve konkrete.<sup>58</sup>

*Komiteti i Helsinkit me kënaqësi konstaton një përparim të madh në media dhe njoftim*

57 Në nëntor të vitit 2003, Prokuria publike është tërhequr nga zhvillimi i rastit dhe e lëshoi që ndjekja të bëhet nga paditësi privat.

58 Sidomos drastike në këtë rast janë shkrimet e profesorëve të fakultetit juridik Ljubomir Frçkovski dhe Marjanoviç të cilët paraqiten si kolumnist të rregullt në gazetën “Dnevnik”.

mediatik në drejtim të promovimit dhe mbrojtjes të të drejtave të qytetarëve. Trajnimi i mëtutjeshëm, dhe sensibilizimi dhe para së gjithash rritja e njohurive në fushën e të drejtave të njeriut, munden që edhe më shumë të përforcojnë rolin e mediave në të animuarit dhe mobilizimin e publikut në drejtim të mbrojtjes të këtyre të drejtave.

Mediat duhet të përkushtojnë përpjekje serioze në tejkalimin e mëtutjeshëm të ngjyrimin etnik të informacioneve personale dhe lirimin nga ndikimet partiake në përzgjedhjen e mënyrës të prezantimit të informacioneve.



## 6. Marrëdhëniet ndëretnike

Krahas proceseve të deklaruara integrale, gjatë vitit 2003 është i dukshëm dezintegrimi i hapur i popullsisë në territorin e Republikës të Maqedonisë mbi bazat etnike. Çështjet e të drejtave të komuniteteve pakicë dhe realizimi i mjedisit të tillë demokratik në të cilin të gjithë qytetarët e Republikës të Maqedonisë do të ndjehen të barabartë dhe komod, në mënyrë shkallëzore janë transformuar në çështje të lidhura me realizimin e pushtetit të partive të caktuara, ndarjen e privilegjeve dhe redifinimin e prioriteteve të shtetit. Në këto procese dhe aktivitete, Republika e Maqedonisë në mënyrë shkallëzore e humb karakterin e shtetit multi-etnik dhe faktikisht transformohet në dyetnike.

Ekskluziviteti i etnoidentifikimit në secilin segment të konstituimit të pushtetit në masë të madhe rrezikon proceset transformuese globale dhe pamundëson përfundimin e demokracisë qytetare. Këto procese pasqyrohen veçanërisht në mënyrë negative në ngritjen e njohurive të individëve, si shtyllë e konceptit të lirisë dhe të drejtave të njeriut. Marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të bashkësive të ndryshme etnike nuk kanë sukses që të tejkalojnë nivelin e marrëdhënieve të kolektiviteteve dhe pamundësojnë fleksibilitetin në të gjithë format tjera të shoqërimit interesant të qytetarëve.

Paralelizmi i bashkësive ngrihet në nivel të rregullave dhe partive politike në pushtet jo vetëm që nuk destimulojnë këtë por e mbështesin çdo aktivitet të drejtuar drejtë ndërtimit të institucioneve paralele (deri në nivel të paralelizmit të objekteve themelore infrastrukturore si:

ambulancat, stacionet e autobusi, shitoret, fushat sportive) struktura dhe hapësira të jetësës të anëtarëve të bashkësive të ndryshme etnike.

Në kushtet e sjelljes të bashkëveprimit të bashkësive etnike vetëm në nivel të kolektivitetit, fshirjes të gjithçkaje që është e përbashkët dhe të ndërlidhjeve, zvogëlimi i mundësive për komunikim të drejtëpërdrejtë dhe ndarje të problemeve, është shumë e pritshme që të vijë deri te rritja e sërishme e tensioneve ndërmjet anëtarëve të bashkësive të ndryshme etnike. Mosdurimi i ndërsjellë manifestohet në jetësën e përditshme në nivel të mohimit të qetë dhe mospranimit, por edhe në demonstrata të hapura të urrejtjes dhe mohimit dhe shkeljet e lirive dhe të drejtave themelore në momente të caktura të konfliktit. Fakti që konfliktet zhvillohen para së gjithash në raport me bashkësisë etnike shumicë maqedonase dhe bashkësisë etnike pakicë shqiptare, nuk përjashton bashkësitë tjera etnike, si nga përfshirja e drejtëpërdrejtë, ashtu edhe nga vuajtja e pasojave të drejtëpërdrejta në të drejtat dhe interesat personale.

- 1. Pastrimi etnik dhe kufizimi etnik është procesi më i rrezikshëm që ka marr hov gjatë vitit 2003. Prosesi filloi në hapësirat ku ka ndodhur konflikti i armatosur në vitin 2001 dhe nga i cili është shpërngulur pjesa më e madhe e popullsisë joshqiptare. Duke patur parasysh se as në vitin 2003 nuk janë krijuar kushtet për kthimin e personave të shpëngulur, situata merr përmasa të zgjidhjes të përhershme.<sup>59</sup> Paralelisht me këtë zhvillohet procesi i migrimit të brendshëm të popullsisë në ato vendbanimi (sidomos qytetet), me çrast vizatohen kufijtë e qartë etnik
- 2. Prosesi është potencuar më vonë me pastrimin etnik në shkollimin fillor dhe të mesëm. Gjatë vitit 2003 është zvogëluar në mënyrë domethënëse numri i shkollave në të cilat mësimi realizohet në më shumë gjuhë. Madje edhe atëherë kur nën të njëjtin kulm ndodhen fëmijët nga bashkësitë e ndryshme etnike, zakonisht është që ato të mësojnë në ndrrime të ndryshme dhe të mos kenë asnjë takim as në aktivitetet shkollore as në aktivitetet jashtëshkollore.<sup>60</sup> Numër i madh i tensioneve shumëetnike në vitin e kaluar janë lidhur pikërisht me arsimin, kur pushteti aktual është treguar shumë i ashpër dhe josensibil dhe është përpjekur që me masa dekretuese të bëjë ndryshime që mënyra të ndryshme ndikon në marrëdhëniet ndëretnike.<sup>61</sup>

59 Ky proces është në masë të madhe i mbështetur nga popullsia vendore nga komuniteti shqiptar që manifestohet me shkatërrimin e shtëpive tashmë të rikonstruara në pronësi të popullsisë joshqiptare (për shembull në f. Matejç dhe në fshatin Haraçinë) sjellja e dhunshme dhe frikësimi i anëtarëve të komunitetit maqedonas dhe pamundësimi që të kryhen punët e fshatit (në f.Luboten), hedha e gurëve dhe dëmtimi i objekteve fetare (manastiri Shën Nikolla në f.Luboten).

60 Një nga shembujt e rrallë në gjimnazin në të cilën nxënësit nga bashkësitë e ndryshme etnike ndjekin mësimin në të njëjtën kohë në gjimnazin e Gostivarit “Pançe Popovski” (edhe pse këtu është i dukshëm procesi dezintegruës në ekzistimin e tri tabelave të ndryshme të maturantëve, të nxënësve që kanë ndjekur mësimin në maqedonisht, shqip apo në gjuhën turke).

61 Në Kumanovë pas përpjekjes të pasuksesshme të Ministrisë të arsimit për zgjidhjen e problemit me nxënësit



- 3. Si veçanërisht problematik është paraqitur edhe votimi i Ligjit për themelimin e universitetit të tretë në Republikën e Maqedonisë (në të cilin mësimi do të zhvillohej në gjuhën shqipe).<sup>62</sup> Edhe pas zgjidhjes të këtij problemi është shumë i dukshëm problemi i alternativave, diskutimit më të gjërë, përkufizimit të qartë të qëllimeve dhe procedurave.<sup>63</sup> Amendamentet kushtetuese japin mundësinë për formimin e Universitetit në të cilin mësimi do të realizohet në gjuhën shqipe, megjithatë shtrohet pyetja se pse Propozimi i ligjit për formimin e këtij universiteti është vënë në procedure urgjente, si dhe çështja, se si më së miri një projekt i tillë mund të përfshihet në proceset e deklaruara integruese. Shqyrtimet në Kuvend tregojnë në atë se mos pasja e alternativave t; propozimit mund të rrezikojë zgjidhjen e vërtetë të problemeve në lidhje me këtë çështje.
- 4. Përdorimi i gjuhëve është paraqitur si një segment i rëndësishëm në realizimin e të

e shkollës të mesme të bashkësisë shqiptare që nuk deshin të kthehen në ndërtesën amë të gjimnazit “Goçe Dellçev” sipas parimit “hap pas hapi” dhe pas përpjekjes për kthimin e një pjesë të nxënësve të shkollës të mesme në shkollën e mesme amë “Nace Buxhoni” (pasiqë janë penguar nga një grup e nxënësve dhe prindërve nga bashkësitë joshqiptare) dhe pas reagimit të tyre (bllokimin e hyrjes dhe Kumanovë dhe greva e urisë e një pjesë të prindërve) Ministria e arsimit dhe shkencës ka vendosur për një “vendim të përkohshëm derisa të qetësohet gjakrat” – 800 nxënës etnik shqiptar të përfundojnë vitin mësimor në hapësirat e ZIK “Kumanovë”, kurse 910 nxënës të mësojnë në “Shtëpinë e punëtorëve”.

Ministria për asrim ka marrë vendim për formimin e paraleles të gjimnazit në gjuhën e mësimin në shqip në Manastir (e cila si hapësirë do të vendoset në SHF “Goçe Dellçev”. Vendimi është në aspekt juridik dhe arsimor i përmbajtur, megjithatë është miratuar në mënyrë krejtësisht jotransparente, pa konsultime të mëparshme me administratën e gjimnazit, në shkollën e mesme, të prindërve të nxënësve, dhe pa arsyetim dhe argument përkatës para publikut që ka dhënë shkas për protestat me ngjyrë etnike nga ana e prindërve dhe nxënësve të bashkësisë maqedonase (por edhe nga publiku më i gjërë në Manastir), prishjen e procesit arsimor, dhe tërheqjen e kërkesës për hapjen e paraleles, respektivisht tërheqjen e paraleles në “ilegalitet”. Sërish problemi nuk është zgjidhur, por si i tillë është fshehur dhe paraqet burim të mundshëm për konfliktet e ardhshme.

Në fillim të vitit mësimor 2003, Ministria e arsimit ka marrë edhe vendimin për përfshirjen e paraleleve të dislokuara hapësinore në gjuhën e mësimin shqip drejtë shkollës të mesme amë “Arseni Jovkov” në Shkup. Sipas informacioneve të fituara edhe ky vendim është marrë pa një analizë paraprake të gjendjes, pa informim dhe konsultime me administratën, arsimtarët, nxënësit dhe prindërit në shkollën amë dhe në paralelet e dislokuara, si dhe pa një arsyetim përkatës për vetë vendimin, për pasojat nga vendimi dhe zgjidhjet që referohen. Si rezultat i mostransparencës, dezinformimit dhe manipulimeve të shumta, është krijuar atmosfera e mosbesimit që rezulton në konflikt. Numër i madh i nxënësve kanë munguar në mësim dhe janë përfshirë në protesta dhe manifestime në masë të madhe me ngjyrosje nacionaliste. Vendimi i kompromisit (në vend se 11, në shkollën amë të vendosen 7 paralele në gjuhën mësimore shqipe) duke mundësuar kthimin e nxënësve në mësim, megjithatë në asnjë rast nuk ka ulur tensionet që kanosen në kohën e ardhme të eskalojnë sërish në një konflikt të hapur. Të përfshirët nuk kanë pranuar që të mendojnë për zgjidhje tjera alternative (si për shembull: vendosjen e trevjeçarëve në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe në shkollën amë, e dislokimin e të gjithë paraleleve nga viti i katërt në hapësirën që kënaq nevojat për trajnim praktik).

62 Duke patur paraysh se me këtë në fakt do të mundësohet legalizimi i një pjese të fakulteteve të cilët ekzistojnë në kuadër të universitetit jolegal në Reçicë të Vogël, problem merr njohuri specifike dhe del jashtë fushës arsimore. Kushtëzim t; veçantë paraqet çështja për njohjen e diplomave që janë lëshuar në këto fakultete deri në momentin e etablimit të tyre juridik në kuadër të sistemit.

63 Kjo në asnjë rast nuk mund të arsyetohet për demonstratat masive me ngjyrë nacionaliste të studentëve nga universiteti i Shkupit dhe Manastirit, të mbështetura nga kryetari i Senatit të Universitetit “Shën Kiril dhe Metodi” nga Shkupi dhe numër i madh i profesorëve dhe dekanëve nga fakultetet e këtyre universiteteve.

Sidomos shqetëson e dhëna se edhe në shqyrtimin parlamentar dhe në mbështetje të protestave studentore, partia opozitare VMRO DPMNE ka marrë qëndrim të hapur negativ për idenë e formimit të Universitetit në gjuhën shqipe.

- drejtave të bashkësive etnike, por edhe si burim i tensioneve dhe konflikteve gjatë të gjithë vitit 2003.<sup>64</sup> Realizimi i kësaj të drejte me zbatimin ekskluziv të parimit të përfaqësimit në përqindje, paraqet edhe një godtije të multikulturalizmit të Republikës të Maqedonisë, në fakt i gjithë diskutimi për përdorimin e gjuhëve zhvillohet në lidhje me përdorimin e gjuhës maqedonase dhe gjuhës shqipe, ndërsa gjuhët tjera në mënyrë shkallëzore në tërësi tërhiqen nga fusha e përdorimit publik.<sup>65</sup> Nëse shohim nga ana tjetër, kjo çështje shqetëson në mënyrë të veçantë për shkak të paraqitjes apo intencës që gjuha e dytë zyrtare të përdoret si gjuhë e vetme gjatë kryerjes të funksioneve publike. Kjo lidhet me moskuptimin e qartë të rëndësisë të dygjuhësisë (sidomos në veprimin e administratës lokale dhe pushtetit lokal), që nënkupton njohje të shkëlqyer të gjuhëve që janë në përdorim zyrtar në komunën e caktuar.<sup>66</sup>
- 5. Nga aspekti i të drejtave të bashkësive tjera etnike, edhe më tutje veçanërisht shqetëson pozita e anëtarëve të popullsisë rome. Në vitin 2003 nuk është bërë asgjë në drejtim të përmirësimit të standardit dhe kushteve të jetesës të anëtarëve të kësaj bashkësie etnike.<sup>67</sup> Getoizimi i lagjeve rome vazhdon dhe mundëson diskriminim në lidhje me dhënien shërbimeve komunale, ndryshimeve infrastrukturore dhe ndërtimin e objekteve të rëndësishme për zhvillimin e komunitetit. Për shkak të kushteve nën standard të jetesës, këto lagje shpesh ekspozohen në fatkeqësi ekzistenciale dhe përballen me dëme

64 Pas arritjes të pajtueshmërisë për përdorimin e gjuhëve (maqedonase dhe shqipe) në diskutimin parlamentar është zhvilluar një kontest për atë se në cilën gjuhë do të duhet të zhvillohen komisionet parlamentare të cilat udhëhiqen nga anëtarët e bashkësisë shqiptare. Mosmarrëveshja është zgjidhur pas diskutimeve dhe cilësimeve njëmujore.

65 Këtë e godet edhe refuzimi shumëvjeçar i Republikës të Maqedonisë që të ratifikohet Karta për gjuhët rajonale apo të pakicave.

Në kontekst të përdorimit të gjuhës turke janë paraqitur rastet e anashkalimit të të drejtës të arsimit fillor në gjuhën personale amtare. Për shembull, që në vitin 1993, Ministria për arsim ka vendosur që 300 fillorist që kanë ndjekur mësimin në gjuhën turke të transferohen nga “Jordan Konstantinov - Xinot” – Koliçani i Poshtëm në “Tefejuz” - Gazi Babë, me distancë prej rreth 20 km nga shtëpitë e tyre. Në janar të vitit 2003, me kërkesë të prindërve, është miratuar vendimi që 129 nxënës nga klasat 1-4 t’i kthehen mësimin në “Jordan Konstantinov - Xinot”. Prindërit shpresojnë se do të përmbushet edhe kërkesa e tyre për kthimin e filloristëve tjerë nga klasat 5-8. Në të njëjtën kohë vërehet tendenca e “që të harrohet” gjuha maqedonase pikërisht nga ana e përfaqësuesve të bashkësisë turke (që është sidomos e dukshme në Maqedoninë perëndimore).

66 Duke patur parasysh se si kompleksiteti i çështjes gjuhësore si dhe disa gabime në zbatimin e tij nga pavarësimi e deri sot, Komiteti i Helsinkit e mbështet iniciativën e Qeverisë, duke u kujdesur për Ligjin e tashëm të vlefshëm për përdorimin e gjuhës maqedonase, që të miratohet ligj i veçantë për përdorimin e gjuhëve. Por, ky nuk do të duhet të jetë Ligj për përdorimin e gjuhëve të kombësive as edhe të bashkësive etnike, duke patur parasysh se përdorimi i një gjuhe nuk është, e as që mund të jetë kriteri i vetëm për përkatësinë në bashkësinë e caktuar dhe nuk është dhe nuk mund të jetë “arsyetim” për mosnjohjen e gjuhës maqedonase si gjuhë shtetërore. Rrjedhimisht, është e domosdoshme që të krijohen kushte nga kushtet ligjore deri te ato faktike për dygjuhësinë e vërtetë të bashkësive të diferencuara gjuhësore, por në të njëjtën kohë të nxitet përfshirja e tyre sociale në të gjithë fushat tjera.

67 Popullsia roma ende është në fund të shkallëve arsimore, në fund të shkallës për punësim, kurse në majë të pranuesve të ndihmës sociale. Përqindja e romeve të papunësuar është tre herë më e madhe nga përqindja e përgjithshme e të punësuarve në Republikën e Maqedonisë.

- të mëdha materiale apo paraqesin kërcënim të drejtëpërdrejtë për jetën dhe shëndetin
- e banorëve të tij. Në rastet e tilla, politikanë shumë shpesh japin premtime për ndihmë,
- megjithatë këto premtime zakonisht nuk përmbushen.<sup>68</sup> Romët janë ende lëndë e
- diskriminimit të hapur racor dhe marginalizimit.<sup>69</sup>
- 
- 6. Në vitin 2003, disa herë kanë reaguuar anëtarët e bashkësisë turke me vërejtje të hapura
- në lidhje me zvogëlimin e të drejtave të tyre, respektivisht akte të diskriminimit. Deri te
- Komiteti i Helsinkit janë përcjellur më shumë njohuri të cilat tregojnë se përqindja e vogël
- e përfaqësimit të turqve etnik në sektorin publik, mes të tjerash ka të bëjë me mungesë
- të kuadrove, që është rezultat edhe i përfaqësimit joadekuat të gjuhës tuke në arsimin
- fillor, të mesëm dhe të të lartë në Republikën e Maqedonisë.<sup>70</sup>

*Komiteti i Helsinkit konsideron se në vitin 2003 nuk është bërë hap pozitiv në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike. Paralelizmi etnik e rrezikon të gëzuarin e vërtetë dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut në përgjithësi. Sulmi i veçantë është kryer mbi multikulturalizmin e shoqërisë maqedonase dhe si bazë për zhvillim të demokracisë qytetare. Është i dukshëm marginalizimi i mëtutjeshëm i ndikimit të komuniteteve pakicë jo shqiptare dhe mungesa e interesit të shteti që të respektojë pjesën më të madhe të dispozitave të Konventës kornizë për mbrojtjen e pakicave nacionale, respektivisht të ratifikojë Kartën për gjuhën rajonale apo pakicë.*

68 Si në rastin me sanimin e pasojabr nga rrëshqitja r tokës në lagjen Ramina në Veles.

69 Gjykata e Apelit Shkup, në rastin H.E, e ka shfuqizuar aktëgjykimin e e shkallës të parë të Gjykatës themelore në Kriva Pallankë për shkak se ka vërtetuar se "...rasti social i personit të papunë... është e qartë se pagat e tij materiale as edhe kontributet e tij kanë mundësuar që të blejë për nevojat e tij 10 complete çarshafë, 13 bluza me mëngë të shkurtra, 20 shallë dhe 4 fustan gjumi..."(Për arsytet e autenticitetit, në citat nuk kemi intervenuar as në aspekt të mendimit.)

70 Shoqata për arsim, kulturë dhe art "Adeksam" ka paraqitur kërkesën për hapjen e paraleleve të reja në gjuhën turke në shkollat fillore dhe të mesme në pajtim me nevojat e ligjeve ekzistuese dhe iniciativa për formimin e grupeve të veçanta për mësim në gjuhën shqipe në "Universitetin e Shtutit, duke marrë parasysh të dhënat se për atë nuk ka vetëm nevojë (presioni mbi qindra student etnik turq të ndjekin mësimin në gjuhën shqipe, edhe pse nuk e kuptojnë), por edhe edhe kapacitet të disponueshëm.

Shoqata për zhvillim të mediave në gjuhën turke ka bërë thirrje deri te publiku që të reagojë në zhvendosjen dhe shkurtimin e orarit për emitimin e programit në gjuhën shqipe në Televizionin e Maqedonisë. Ata tregojnë edhe për precedentin e rrezikshëm që ka ndodhur në datë 13.12.2003, kur pas 35 viteve, programi në gjuhën turke nuk ka emituar lajme në gjuhën turke. Kjo shoqatë paralajmëron se në Maqedoni nuk ka media tjera elektronike në gjuhën turke, dhe është mbyllur edhe i vetmi medium i shtypur në gjuhën turke "Birlik".

## ● 7. E drejta e lirisë

### ● të besimit dhe

### ● përcaktimit religjioz

Qëndrimi i përgjithshëm i Komitetit të Helsinkit në lidhje me realizimin e lirisë të besimit të sekularizmit të përgjithshëm të shtetit, kurse ndryshimet të cilat u referohen bashkësive fetare të realizohen në formën e vlefshme juridike.

Pas shfuqëzimit të dhjetëra neneve nga Neni për komunitetet fetare dhe grupet religjioze nga ana e Gjykatës kushtetuese, janë bërë disa përpjekje për hartimin e ligjit të ri të cilat përfundojnë pa sukses. Në asnjë prej këtyre hartimeve nuk janë përfshirë përfaqësues nga të gjithë komunitetet fetare (25) në Republikën e Maqedonisë.

Me ndryshimet kushtetuese, të bëra në bazë të rekomandimeve të përmbajtura në Marrëveshjen kornizë nga Ohri, në nenin 19 nga Kushtetuta vazhdimisht përmenden pesë komunitete fetare, kurse të tjerëve u garantohet status i barabartë.<sup>71</sup> Me këtë kompromis definitivisht është dëshmuar se nuk ekziston kuptim elementar të rëndësisë të lirisë dhe besimit dhe bëhet keqkuptim i nocioneve që do të kenë pasoja afatgjate në një numër të madh të zgjidhjeve ligjore dhe zgjidhjeve tjera.<sup>72</sup>

Në Kushtetutë është garantuar ndarja e shtetit nga religjioni (kisha), megjithatë në praktikë, lejohet dhe nxitet, vendi i veçantë për Kishën ortodokse maqedonase dhe në numër të madh të rasteve shkilet ndarja ndërmjet kishës dhe shtetit.<sup>73</sup>

71 Në këtë mënyrë në vetë Kushtetutë është mbajtur një nga elementet thelbësore të diskriminimit me bazë të konfesionit dhe besimit. Në bazë të kësaj më tutje nxirret përfundimit (që së fundi edhe qartazi është theksuar nga ana e kryetarit të VMRO DPMNE, Nikola Gruevski), se kisha është kategori kushtetuese dhe nga aty do të duhet të rrjedhin të gjithë zgjidhjet e mbetura ligjore). Në këtë mënyrë, në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut në Kushtetutën e Republikës të Maqedonisë, në vend se të bëhet fjalë për lirinë e besimit, bëhet fjalë për vendosjen pozitës të privilegjuar të religjionit të caktuar, respektivisht besimit të caktuar.

72 Në kohën e fundit është shprehur veçanërisht ndjekja e përfaqësuesve të Kishës ortodokse serbe, të cilëve u ndalohet hyrja në territorin e Republikës të Maqedonisë, kurse ndjekësit e tyre (shtetas maqedonas) ekspozohen në trysni të vazhdueshme (bastisje të shtëpive, thirrja në bisedë nga ana e policisë, konfiskimin e materialeve në gjuhën serbe dhe shpifjen në media). Këto procedura arsyetohen me kontestin ndërmjet kishës ortodokse maqedonase dhe serbe në të cilin intensivisht janë përfshirë pushtetet e të dy shteteve. Sipas informacioneve të fundit në procedurë parlamentare ka hyrë ndryshimi i Ligjit për bashkësitë fetare dhe grupet religjioze, me të cilat me ligj do të pamundësohet veprimi i këtyre grupeve. Është interesante që shumë shpesh në vlerësimin e veprimit të bashkësive tjera fetare përdoret terminologjia që është karakteristike për periudhën e ardhshme (siç është për shembull fraza: veprimi armiqësor dhe propaganda armiqësore).

73 Në kërkesat e tyre për pozitë të veçantë dhe nënshtruar në lidhje me të gjithë besimet e ndryshme në lidhje me bashkësitë tjera fetare, Kisha ortodokse shfrytëzon, para së gjithash kanalet e të kaluarës (prania historike në fazat kryesore zhvillimore të kulturës të popullit maqedonas) dhe përpiket që të vendos lidhje me çdo ngjarje të rëndësishme nga historia e popullit dhe shtetit. Letra kryesore në të cilën luan Kisha ortodokse është identiteti i maqedonasve, duke u vendosur në rol të parametrin të domosdoshëm të identifikimit të mëparshëm, të tashëm dhe çdo të ardhshmi. Kisha ortodokse vendos problemt e pranimit personal dhe mëvetësisë me lidhje direkte me

Komunitetet më të vogla religjioze ankohen se janë ekspozuar në presione të vazhdueshme, kërcënime dhe se diçka pamundëson zhvillimin normal të aktiviteteve.<sup>74</sup>

*Momentalishte gjendja në Republikën e Maqedonisë shumë pak godet lirinë e të shprehurit dhe besimit dhe përcaktimin religjioz të njerëzve. Në praktikë, njerëzit në Republikën e Maqedonisë, kanë liri shumë të vogël të përzgjedhjes të besimit personal. Presionet lëvizin nga ato më fundamentalet (çështja e identitetit), deri te ato që nuk janë të përditshme, por jo edhe më pak të rëndësishme (punësim, orientim politik, arsim). Individit i pamundësohet që të veprojë në mënyrë individuale, por shtyhet drejtë “kopesë” specifike të tij në të cilën mund të vlerësohet dhe pranohet në mënyrë përkatëse.*

*Në kontekstin aktual të marrëdhënies, liria e besimit shëndrrohet në liri të kishës, që në vete është organizim i mundësisë për përzgjedhje, të fleksibilitetit të identitetit personal dhe paraqet anakronizëm prej të cilit kanë sukses të lirohen numër i madh nga vendet e demokracisë të zhvilluar (kurse ne ende po e pranojmë) .*

---

pranimin dhe ekzistimin e shtetit si në të kaluarën ashtu edhe në momentin e ardhshëm dhe kërkon (dhe fiton) një angazhim të drejtëpërdrejtë të strukturave shtetërore në zgjidhjen e problemeve personale. Në këtë qëllim shfrytëzohen edhe momente të tilla formale siç është vendi i zhvillimit të ngjarjes të caktuar (si në rastin e mbledhjes të ASNOM-it), që të vendoset një lidhje e rrejshme ndërmjet vendosjes formale të shtetësisë të Maqedonisë në vitin 1944 dhe kishës ortodokse. Lidhja konkrete paraqet edhe absurd, por edhe ofendim të delegatëve të kësaj mbledhjeje që në masë më të madhe e kanë mbështetur qëndrimin jo vetëm për ndarjen e kishës nga shteti, por edhe largimin e tërësisht të çfarëdo simbolesh kishtare nga jeta publike. Lidhja e ngushtë e kishës ortodokse maqedonase me shtetin e vendosur në mandatin e strukturës të mëparshme qeveritare, vazhdon edhe në pushtetin e ri. Ajo manifestohet me praninë e vazhdueshme të përfaqësueve të kishës ortodokse maqedonase në kremtimin e ngjarjeve të karakterit shtetërorë, prania e madhe në mediat shtetërore dhe prania në aktivitetet ndërkombëtare të udhëheqësisë shtetërore

74 Problemet më të mëdha mund të lokalizohen në: rregullimin e marrëdhënieve personale (komuniteti bektashi nuk mund të realizojë të drejtat personale mbi objektin e Teqes të Arabati Babës, që është uzurpuar nga ana e bashkësisë islame dhe është ridestinuuar në ndërtim të xhamisë); ndërtimi i objekteve të reja (në planet urbanistike nuk janë paraparë lokacione të mjaftueshme për ndërtimin e objekteve fetare); hapësira e pamjaftueshme për kryerjen e aktiviteteve fetare (sipas ligjit për aktivitetet fetare të të gjithë bashkësive fetare përveç Kishës ortodokse dhe bashkësisë islame, janë kufizuar në hapësirën e bashkësisë që është regjistruar në mënyrë speciale dhe që është parashikuar për këtë); sulmet e hapura mbi personat dhe objektet (në Strumicë është pamundësuar nga ana e klerikëve të kishës ortodokse dhe ndjekësve të tyre vendosja e gurthemeleit dhe ndërtimi i Kishës katolike; në Prilep në mënyrë të njëjtë është pamundësuar ndërtimi i hapësirës për dëshmitarët e Jehovës); pengesa në realizimin e shërbimit fetar dhe ligjeratave nga ana e mysafirëve të ftuar nga jashtë shtetit (sipas ligjit nevojitet një leje e veçantë për çfarëdo ligjerate fetare apo shërbimi nga ana e personit të huaj); ndalesë për hapjen e kishës ortodokse në të cilat shërbimi fetar do të realizohet në gjuhë tjetër (vllëhe, sërbe, greke).



## Përfundim

Gjendja me të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë në vitin 2003 nuk ka ndryshuar në mënyrë thelbësore në lidhje me periudhën paraprake. Në fusha të caktuara (sidomos të drejtat sociale, shëndetësore dhe të drejtat nga marrëdhëniet e punës) janë të dukshme edhe zhvendosjet retrograde. Shteti jo vetëm që nuk arriti të ndërtojë një sistem të tillë të institucioneve dhe mekanizmave që mundësojnë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve, por ende paraqitet si shkelës më i madh i këtyre të drejtave.

Karakteristike për vitin 2003 është rrumbullakësimi i partizimit të tërësishëm të strukturës shtetërore, zhvillimi i etnodemokracisë në llogari të demokracisë qytetare dhe erozionit të mëtutjeshëm të së drejtës si garancë themelore të mbrojtjes të njeriut.

Vitin e kaluar nuk është realizuar asnjë nga përpjekjet deklaruese të strukturës të sapozgjedhur në pushtet (përmirësimi i situatës të sigurisë në shtet, përmirësimi i situatës ekonomike, dhe përmirësimi i standardit jetësor të popullsië, demokracisë globale, respektimit të të drejtës dhe zhvillim të shtetit juridik, zhvillim të proceseve integruese në vend të atyre dezintegruese në Republikën e Maqedonisë, dhe nivel të tillë të respektimit të përgjithshëm dhe mbrojtjes të lirive dhe të drejtave të njeriut që do të afrojnë shtetin deri te rrjedhat europiane dhe do të mundësojë anëtarësimin e përsheptuar në strukturat europiane).

(15.01.2004)







KOMITETI I  
 **HELSINKIT**   
PËR TË DREJTAT E NJERIUT  
I REPUBLIKES SË  
MAQEDONSË